

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6083
E hënë, 10 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Opozita kritikon qeverinë
për futjen e xhandarmërisë
serbe në Kosovë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", HEKURAN MURATI | FAQE 4-5

ME QEVERINË HOTI AS QË MUND TË MENDOHEJ RIMËKËMBJA EKONOMIKE

- Koordinimi i PDK-së
me LDK-në në shumë
raste është më i mirë
sesa i kësaj të fundit
me partnerët zyrtarë
të koalicionit



Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga
partia Lëvizja Vetëvendosje, Hekuran
Murati, ka thënë se me qeverinë Hoti
as që mund të mendohet rimëkëmbja
ekonomike. Ai ka theksuar se kjo qe-
veri jo vetëm që ka dështuar në aspek-
tin ekonomik, por edhe në atë të
menaxhimit me pandeminë Covid-19.
Në këtë kontekst, Murati i ka thënë
"Epokës së re" se Kosovës i duhet një

pako e dytë emergjente ekonomike, e
cila, sipas tij, do ta siguronte mbi-
jetesën e qytetarëve. Sipas Muratit,
Projektligji për rimëkëmbjen
ekonomike, i propozuar nga qeveria
Hoti, nuk e adreson fare këtë çështje.
Ndërsa sa i përket mocionit për rrëz-
imin e kësaj qeverie, Murati ka thënë
se është detyrë e Vetëvendosjes që ta
ndalë të keqen sa më herët që është e

mundur, duke shtuar se PDK-ja si
parti në opozitë ka ndryshuar qën-
drim sa i përket kësaj teme. "Kjo
vetëm e betonon atë që e kemi thënë
që në fillim, se PDK-ja është opozitë
vetëm në letër sepse, në fakt, koor-
dinimi i saj me LDK-në në shumë
raste është më i mirë sesa i LDK-së me
partnerët zyrtarë të koalicionit", është
shprehur Murati

OPINION

ASNJË DITË PUSHTETI I
PARTISË DEMOKRATIKE I
SHOIPËRISË DHE SALI
BERISHA NUK E KANË
PËRKRAHUR UÇK-NË (27) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



KUFIRI I KOSOVËS ME
SERBINË NDAN PERËNDIMIN
ME LINDJEN F. 11

Shkruan: Prof. Ass.
Dr. Sabri KIÇMARI



AKTUALE

12 TË VDEKUR, 142 TË SHËRUAR
DHE 188 RASTE TË REJA ME
COVID NË KOSOVË F. 6

JAKUP KRASNIQI SHËROHET
NGA COVID-19 F. 6

EKONOMI



PAKOJA EMERGJENTE, NGA SOT
NIS EKZEKUTIMI I MJETEVE
FINANCIARE PËR PUNËTORËT
DHE BIZNESET F. 9

RRETH 100 MILIONË EURO
MË PAK TË HYRA NË ARKËN
E SHTETIT F. 9

BIZNESET NËPËR KOMUNA, NË
GJENDJE TË RËNDË F. 9



LDK-ja DHE AAK-ja S'PAJTOHEN PËR DIALOGUN

LDK-ja dhe AAK-ja nuk po arrijnë të
gjejnë një gjuhë të përbashkët për
procesin e dialogut Kosovë - Serbi.
Mospajtimet e partnerëve të koali-

cionit për këtë çështje po
vazhdojnë. Ndaj kritikave të AAK-së
për këtë proces ka reaguar
zëvendëskryeministrit Diton

Selmanaj. Ai ka thënë se autoriteti i
vetëm në këtë proces është kryeministri
dhe se dialogu teknik me Serbinë i
takon të kaluarës | FAQE 3

HOTI: HAPJA E SHKOLLAVE VARET NGA
SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

LSDM-ja: Në bisedimet me BDI-në kemi rënë dakord në disa pika

SHKUP, 9 GUSHT - Partia fituese e zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut, LSDM-ja që drejtohet nga Zoran Zaevi, ka bërë me dije se nga bisedimet e zhvilluara me Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI) të Ali Ahmetit për formimin e shumicës parlamentare dhe krijimin e qeverisë së re janë pajtuar për disa pika, në mesin e tyre respektimi i Marrëveshjes së Prespës, marrëveshjes për fqinjësi të mirë me Bullgarinë si dhe për respektimin e Marrëveshjes së Ohrit por që, sipas kësaj partie, ende nuk ka marrëveshje. "Jemi të përkushtuar në kohezionin shoqëror, shoqëri të fuqishme dhe tolerante, sundimin e së drejtës dhe jemi të gatshëm që të kundërshtojmë çdo formë të nacionalizmit dhe urrejtjes. Kemi biseduar se programi eventual i

përbashkët për qeverisje duhet të jetë në pajtueshmëri me Kushtetutën, ligjet dhe programin zgjedhor të LSDM-së dhe BDI-së", është thënë në komunikatën e LSDM-së. LSDM-ja ka deklaruar se janë të nevojshme kuadro të nevojshme, të propozuara nga të dyja palët për drejtimin e Maqedonisë së Veriut. "Partitë kanë rënë dakord për pastrim të gjyqësorit dhe për kontrollim të prejardhjes së parave dhe të kapitalit të funksionarëve, përmes një sistemi që do të përpilohet bashkërisht. Bisedimet për shumicën e re parlamentare vazhdojnë. Është e nevojshme shumicë stabile në Kuvend që do ta sigurojë formimin e një qeverie të re të përgjegjshme që do të shpije fuqishëm drejt rrugës evropiane", është thënë në këtë komunikatë.



Maqedonia e Veriut planifikon të vaksinojë 20 për qind të popullsisë kundër gripit sezonal

SHKUP, 9 GUSHT - Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut ka njoftuar se ka marrë ftesë nga aleanca globale për vaksina dhe imunizim si dhe nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), që t'i bashkohen iniciativës për sigurimin e vaksinës kundër koronavirusit të ri. Po ashtu, në vjeshtë autoritetet po përgatiten të nisnin një program të vaksinimit të 20 për qind të popullatës kundër gripit sezonal. OBSH-ja ka nisur një iniciativë përmes skemës së quajtur "COVAX", ku shtetet pjesëmarrëse në të do të kenë qasje më të lehtë kur të zbulohet vaksina eventuale kundër Covid-



19, sëmundjes që e shkakton koronavirusi i ri. "COVAX" mekanizmi (qasja globale në vaksinat kundër

Covid-19) pritet të rezultojë në zbulimin e një vaksine dhe vendosjen e pandemisë në kontroll në një afat sa më të

shkurtër kohor. Gjatë periudhës së kaluar kemi pasur disa mbledhje, në të cilat janë diskutuar më shumë detaje rreth furnizimit, sasive dhe mënyrës së shpërndarjes të vaksinave", ka njoftuar Ministria e Shëndetësisë së Maqedonisë së Veriut.

Ndërsa drejtori i Qendrës për Shëndet Publik në Maqedoninë e Veriut, Aleksandër Stojanov, i cili është edhe anëtar i Komisionit për Sëmundje Ngjithëse në një intervistë për "Radion Evropa e Lirë" ka theksuar se vaksina do të ketë, por është shumë herët të thuhet se cila është sasia me të cilën do të furnizohet Maqedonia e Veriut si shtet. "Maqedonia e

Veriut është vendosur në listën e Bashkimit Evropian për marrjen e vaksinave kundër koronavirusit. Kur do të furnizohemi dhe me çfarë sasive, nuk mund të themi asgjë në këtë drejtim", ka thënë ai.

Autoritetet shëndetësore kanë paralajmëruar se gjatë stinës së vjeshtës pritet të vaksinohen rreth 20 për qind e popullsisë kundër gripit sezonal. Ky vaksinim, që do të jetë pa pagesë, ka për qëllim ta evitojë përkeqësimin e situatës shëndetësore, që mund të ndodhë me paraqitjen e gripit sezonal, në kohën kur vendi po përballet edhe me pandeminë e koronavirusit.

Covid-19 në Shqipëri: 136 raste të reja, 6 të vdekur dhe 74 të shëruar në 24 orët e fundit

TIRANË, 9 GUSHT - Gjatë 24 orëve të fundit në Shqipëri janë kryer 561 testime për të dyshuar të prekur nga Covid-19, ku 136 persona janë konfirmuar pozitivë. Shpërndarja gjeografike e rasteve pozitive ditore është si vijon: 66 raste në Tiranë, 13 në Krujë, 11 në Shkodër, 8 në Patos, 7 në Vlorë, 6 në Kavajë, nga 4 raste Kuçovë, Fier, nga 2 raste Berat, Librazhd, Kamëz, Gjirokastrë, Sarandë, nga 1 rast Durrës, Mirditë, Mat, Roskovec, Malësi e Madhe, Peqin, Gramsh. Gjatë 24 orëve të fundit janë

shëruar 74 qytetarë, duke e çuar numrin e të shëruarve në 3342, që nga fillimi i epidemisë. Ministria e Shëndetësisë ka theksuar se mjekët familjarë në të gjithë vendin janë duke monitoruar çdo ditë mbi 1 000 persona aktivë me Covid-19, që janë në shtëpitë e tyre. Aktualisht në spitalin Infektiv dhe "Shefqet Ndroqi" janë duke u trajtuar 112 pacientë të konfirmuar pozitivë me Covid-19, ku 18 pacientë janë në terapi intensive, 3 prej të cilëve të intubuar. Në të dy spitalet "Covid", përveç



pacientëve të konfirmuar pozitivë me Covid-19, janë duke marrë trajtim edhe pacientë të dyshuar, të cilët janë duke u trajtuar sipas protokolleve përkatëse. Fatkeqësisht, edhe pas përpjekjeve të mëdha të ekipeve mjekësore, ka ndërruar jetë artisti 53-vjeçar nga Tirana. Gjithashtu, në dy spitalet Covid nuk e kanë fituar dot betejën me sëmundjen, një 61-vjeçar nga Tirana, një 62-vjeçar nga Durrësi, një 76-vjeçar nga Tirana, një 77-vjeçar nga Pogradeci dhe një 87-vjeçar nga Shkodra.

Vazhdojnë polemikat ndërmjet LDK-së dhe AAK-së për dialogun e Brukselit

LDK-ja dhe AAK-ja s'pajtohen për dialogun

LDK-ja dhe AAK-ja nuk po arrijnë të gjejnë një gjuhë të përbashkët për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Mospajtimet e partnerëve të koalicioni për këtë çështje po vazhdojnë ende. Ndaj kritikave të AAK-së për këtë proces ka reaguar zëvendëskryeministrit Diton Selmanaj. Ai ka thënë se autoriteti i vetëm në këtë proces është kryeministri dhe se dialogu teknik me Serbinë i takon të kaluarës



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 9 gusht - Partnerët e koalicionit qeverisës, LDK-ja dhe AAK-ja, nuk po mund të gjejnë një gjuhë të përbashkët rreth procesit të dialogut Kosovë - Serbi. Mospajtimi për këtë çështje të filluar me takimin e parë të kryeministrit Avdullah Hoti me presidentin serb në Bruksel po vazhdon ende. AAK-ja ka kritikuar përbajtjen e dialogut dhe mostransparencën në proces. Ndaj kritikave të AAK-së të dielën ka reaguar zëvendëskryeministrit Diton Selmanaj, i cili ka thënë se autoriteti i vetëm në këtë proces është kryeministri dhe se dialogu teknik me Serbinë i takon të kaluarës. "Për të gjithë ata që ende kanë dilema. Kryeministri i Qeverisë së Kosovës është autoriteti i vetëm ekzekutiv që udhëheq dialogun në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. Platforma e vetme politike për dialog është dhe mbetet

Kushtetuta e Kosovës. Parimet e dialogut: Dialogu zhvillohet për çështje politike, dialogu teknik tashmë i takon së kaluarës; dialogu do të përfundojë me njohje reciproke; marrëveshja do të jetë gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht e obligueshme; marrëveshja përfundimtare do të jetë plotësisht me frymën e Kushtetutës së Kosovës, në të kundërtën nuk do të pranohet assesi", ka shkruar Selmanaj në profilin e vet në "Facebook".

Ai ka treguar se çështjet që nuk do të diskutohen në këto negociata janë: territori, sovraniteti dhe sistemi unitar i shtetit. "Jemi të bindur që ky proces nuk mund të mbyllet suksesshëm pa përkrahjen e miqve tanë ShBA - BE. Kjo përkrahje ekziston dhe për këtë nuk duhet të ketë dilema askush. Kjo temë kërkon transparencë, unitet dhe lidhshmëri me përgjegjësi të larta shtetërore dhe kombëtare. Këtë angazhim dhe përkushtim tashmë e ka dëshmuar qeveria me

kryeministrit Hoti. Tema të tjera të rëndësishme terciare dhe për politika të brendshme dhe me interes ditor kemi dhe do të ketë gjithmonë me bollëk", ka shkruar Selmanaj.

Reagimi i Selmanajt ka ardhur pasi ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, që është edhe përfaqësues i AAK-së në procesin e dialogut të Brukselit, ka kritikuar këtë proces. Selimi, i cili nuk ishte lejuar të merrte pjesë në takimin në mes të Hotit dhe Vuçiqit, ka thënë se nuk mund ta informojë liderin për procesin nëse nuk merr pjesë në takimet e dialogut. "Fatkeqësisht, pjesën në të cilën jam i dizegjuar nuk mund ta kryej me saktësi dhe ta informoj liderin tim i cili më ka dizegjuar. Më ka emëruar që ta

bart këtë pozicion në qoftë se unë nuk kam qasje direkte të informatave. Unë i besoj skriptit dhe pozicionit të delegacionit atje, por mua më pamundëson informimi i saktë në qoftë se nuk jam pjesë përbërëse e atij ekipi, pasi që përtej atij skripti ka çështje të tjera të cilat, po ashtu, janë shumë të rëndësishme. Çështje të tjera të cilat mund të konsiderohen finesa, por janë të rëndësishme për pozicionimin e secilit delegacion", ka thënë Selimi. Edhe zyrtarët e tjerë të AAK-së, duke filluar prej liderit të kësaj partie, Ramush Haradinaj, kanë kritikuar qasjen e kryeministrit në këtë proces. Madje Haradinaj ka deklaruar se nëse vazhdon këtu ky proces, kryeministri nuk do ta ketë përkrahjen e AAK-së.

Mirëpo, nënkryetari i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mospajtimet e këtyre dy partive për këtë çështje nuk duhet të shihen si kërcënim për prishje të koalicionit. "Dyshimet që ka përcjellë AAK-ja te partneri i koalicionit janë se ne po frikësohemi se Bashkimi Evropian po na kthen në vitin 2011, ku bisedohej për çështje teknike dhe jemi të bindur se nuk mund të ketë marrëveshje pa praninë e Uashingtonit zyrtar. Këto sugjerime të AAK-së nuk duhet të shihen si kërcënime për koalicionin, por si këshilla që të drejtohem në rrugën e duhur ku garantohet përmbyllja përfundimtare e problemeve Kosovë - Serbi", ka thënë Lekaj.

Gucati: Ndaleni dialogun me Serbinë, ose do të përballeni me protesta

PRISHTINË, 9 GUSHT - Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Hysni Guçati, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që t'i ndalë bisedimet me Serbinë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka bërë me dije se nëse kryeministri Avdullah Hoti nuk e bën një gjë të tillë do të përballlet me protesta. Kërkesa e Guçatit ka ardhur pas ndalimeve të fundit të ish-ushtarëve të UÇK-së në disa vende në bazë të përditësimit të listës që Serbia i ka dorëzuar Interpolit. "I bëj thirrje kryeministrit Hoti që t'i ndërprisë bisedimet me Serbinë, ose do të përballlet me protesta të përditshme. Arrestimet e fundit të veteranëve të UÇK-së, sipas listës së re të Interpolit që i ka dërguar Serbia, është një dhunim dhe cenim i lirive dhe të drejtave të njeriut që po e bën Interpoli, por edhe

organet e 'drejtësisë' që e kanë miratuar këtë listë apriori pa kurrfarë baze, vetëm me kërkesë të Serbisë. Është tepruar loja me listat e UÇK-së në Interpol. Është shkelje e paprecedan nga Bashkësia Ndërkombëtare që i ka lejuar Interpolit një veprim kaq të padrejtë ndaj pjesëtarëve të UÇK-së", ka shkruar Guçati. Në emër të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, ai i ka ftuar organet vendore dhe ndërkombëtare që të ndërmarrin diçka në këtë drejtim dhe të mos luajnë me dinjitetin e ish-ushtarëve të UÇK-së. "Në emër të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, por edhe në emrin tim personal si kryetar i kësaj organizate, iu bëj me dije, por edhe apeloj publikisht te të gjitha organet e Kosovës, ato ndërkombëtare dhe strukturat e Interpolit dhe EULEX-it: mos luani më me



dinjitetin, lirinë dhe të drejtat njerëzore të veteranëve të Luftës së UÇK-së. Është

tepruar me degradimin e kësaj shtrese të shoqërisë. Bëj apel te bota e qytetëruar, të ndalet

ky represion kaq i egër dhe i njëanshëm që po ndodhë tash e 20 vjet", ka shkruar ai.

Flet për “Epokën e re”, Hekuran Murati

Me qeverinë Hoti as që mund të m

- Koordinimi i PDK-së me LDK-në në shumë raste është më i mirë sesa i kësaj të fundit me partnerët zyrtarë të koalicionit

Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga partia Lëvizja Vetëvendosje, Hekuran Murati, ka thënë se me qeverinë Hoti as që mund të mendohet rimëkëmbja ekonomike. Ai ka theksuar se kjo qeveri jo vetëm që ka dështuar në aspektin ekonomik, por edhe në atë të menaxhimit me pandemisë Covid-19. Në këtë kontekst, Murati i ka thënë “Epokës së re” se Kosovës i duhet një pako e dytë emergjente ekonomike, e cila, sipas tij, do ta siguronte mbijetesën e qytetarëve. Sipas Muratit, Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike, i propozuar nga qeveria Hoti, nuk e adreson fare këtë çështje. Ndërsa sa i përket mocionit për rrëzimin e kësaj qeverie, Murati ka thënë se është detyrë e Vetëvendosjes që ta ndalë të keqen sa më herët që është e mundur, duke shtuar se PDK-ja si parti në opozitë ka ndryshuar qëndrim sa i përket kësaj teme. “Kjo vetëm e betonon atë që e kemi thënë që nga fillimi, se PDK-ja është opozitë vetëm në letër sepse, në fakt, koordinimi i tyre me LDK-në në shumë raste është më i mirë sesa i LDK-së me partnerët zyrtarë të koalicionit”, është shprehur Murati



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 9 GUSHT - Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga partia Lëvizja Vetëvendosje dhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Transfere, Hekuran Murati, ka adresuar kritika të shumta në adresë të qeverisë Hoti në lidhje me menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe rimëkëmbjen ekonomike. Murati në këtë intervistë dhënë “Epokës së re” ka thënë se me këtë qeveri as që mund të mendohet rimëkëmbja ekonomike. “Për vetëm dy muaj qeverisje prejse erdhi në pushtet kjo qeveri jolegjitime, nga vendi që merrej shembull për luftimin e virusit, Kosova tani është shndërruar në vend që kryeson listat globale me numrin e të infektuarve për kokë banori. Si pasojë e këtij degradimi, nuk mund të mendohet më për rimëkëmbje”, ka thënë Murati, duke shtuar se Kosovës i duhet një pako e dytë emergjente, që ta sigurojmë mbijetesën e qytetarëve dhe bizneseve, gjendja financiare e të cilëve është duke u rënduar çdo ditë. Në këtë kontekst, ai ka thënë se Projektligji për rimëkëmbjen ekonomike, i hartuar nga qeveria Hoti, nuk e adreson fare këtë çështje. “E tëra që mund të gjendet në ato pak faqe që ka ky dokument, është propozimi për

t’u mundësuar kontributpaguesve t’i tërheqin 10 për qind të mjeteve të tyre nga Trusti, që në thelb është masë likuiditeti e patargetuar për ndonjë sektor apo industri, dhe propozimi tjetër që ka të bëjë me dhënien e mundësisë qeverisë që t’i shpenzojë 100 milionë euro nga fondi i privatizimit, për shpenzime për të cilat nuk e ka autorizimin nga Kuvendi”, është shprehur Murati. Sipas Muratit, shfrytëzimi i mjeteve të Trustit është logjikë e gabuar. “Që nga themelimi në vitin 2002 për Trustin ka ekzistuar parimi i paprekshmërisë. Pavarësisht se çfarë ndodhë, as qeveria e askush tjetër nuk mund t’i prekë mjetet e Trustit. Ato mjete u takojnë kontributpaguesve dhe mund të tërhiqen vetëm në rastin kur kontributpaguesi arrin moshën e pensionit. Tani me këtë propozim, po shkelet ky parim. Dhe me shkeljen e parimit të paprekshmërisë, Trusti më nuk është i paprekshëm sepse po hapet dera që edhe në të ardhmen, secila qeveri që i ka 61 vota në Kuvend, t’i fusë duart në paratë e Trustit”, ka deklaruar Murati.

Në këtë intervistë, deputeti Murati ka folur edhe për iniciimin e mocionit të Vetëvendosjes për rrëzimin e qeverisë Hoti. Ai ka thënë se e kanë marrë një iniciativë të tillë për shkak të

keqqeverisjes që është duke ndodhur në vendin tonë. “Është detyrë e jona që ta ndalim të keqen sa më herët që është e mundur, jo për të ardhur në pushtet si qëllim në vete, por që ai pushtet të përdoret për ta rikthyer situatën në kontroll dhe të ndalet degradimi i mëtutjeshëm”, ka thënë Murati, duke e kritikuar qasjen e PDK-së në raport me këtë mocion. “Para se të dilnim me mocion, PDK-ja në më shumë se një rast ishte shprehur e gatshme ta nënshkruante mocionin. Tani që dolëm me mocion, ndryshoi qëndrimi i tyre. Kjo vetëm e betonon atë që e kemi thënë që nga fillimi, se PDK-ja është opozitë vetëm në letër sepse, në fakt, koordinimi i tyre me LDK-në në shumë raste është më i mirë sesa i LDK-së me partnerët zyrtarë të koalicionit”, është shprehur Murati.

“Epoka e re”: Z. Murati, si e vlerësoni Projektligjin për Rimëkëmbje Ekonomike dhe, sipas jush, a do të ndikojë në lehtësimin e situatës së krijuar?

Murati: Gjendja e krijuar për shkak të pandemisë e ka rënduar tej mase situatën financiare të qytetarëve, andaj shteti duhet t’u vijë në ndihmë, sidomos shtresave më të prekura. Po ashtu, duhet ndihmuar edhe bizneset që, së paku, të ruhen

vendet e punës. Diçka e tillë ishte bërë me Pakon Emergjente të qeverisë Kurti. Dhe plani ishte që pasi të tejkalohet situata e rënduar pandemike, të vazhdohej me një Pako të Rimëkëmbjes, e cila do të kishte si qëllim ndihmesën për prodhuesit vendorë për eksportuesit, ndihmesë për gratë në biznes, punë të garantuar për të rinjtë që futeshin për herë të parë në tregun e punës dhe shumë masa të tjera. Mirëpo, edhe jetësimi i kësaj pakoje, edhe suksesi në menaxhimin e pandemisë u ndërpre në gjysmë me rastin e ndërrimit të qeverisë. Për vetëm dy muaj qeverisje prejse erdhi në pushtet kjo qeveri jolegjitime, nga vendi që merrej shembull për luftimin e virusit, Kosova tani është shndërruar në vend që kryeson listat globale me numrin e të infektuarve për kokë banori. Si pasojë e këtij degradimi, nuk mund të mendohet më për rimëkëmbje, por na duhet edhe një pako e dytë emergjente, që ta sigurojmë mbijetesën e qytetarëve, gjendja financiare e të cilëve po rëndohet dita-ditës.

Por edhe po të mos kishte degradim të gjendjes pandemike, Projektligji i ashtuquajtur për Rimëkëmbje Ekonomike emërtimin e ka në s’përputhje të plotë me përmbajtjen. Ky projektligj nuk

adreson fare çështjen e rimëkëmbjes. E tëra që mund të gjendet në ato pak faqe që ka ky dokument, është propozimi për t’u mundësuar kontributpaguesve t’i tërheqin 10 për qind të mjeteve të tyre nga Trusti, që në thelb është masë likuiditeti e patargetuar për ndonjë sektor apo industri, dhe propozimi tjetër që ka të bëjë me dhënien e mundësisë qeverisë që t’i shpenzojë 100 milionë euro nga fondi i privatizimit, për shpenzime për të cilat nuk e ka autorizimin nga Kuvendi. I vetmi sektor që është trajtuar në këtë projektligj është ai i gastronomisë. Asnjë sektor tjetër nuk përmendet aty, madje as prodhuesit vendorë. Prandaj, me një projektligj të tillë as që mund të mbahet niveli ekzistues i ekonomisë, e lëre më të ketë rimëkëmbje.

“Epoka e re”: Në kuadër të këtij ligji, pos të tjerash, parashihet edhe tërheqja e mjeteve të Trustit për 10 për qind, ndërkohë ju kenë shprehur skepticizëm për këtë. Pse?

Murati: Hera e fundit kur qytetarët e kanë pranuar një ndihmë nga shteti, kanë qenë pagesat prej Pakos Emergjente nga qeveria Kurti. Prej atëherë, kjo qeveri jolegjitime nuk ka arritur t’u ofrojë asnjë ndihmë të vetme qytetarëve. Në vend të

endohet rimëkëmbja ekonomike



ndihmës nga shteti, qeveria ka vendosur t'u ofrojë qytetarëve që të marrin një pjesë të kursimeve të veta në Trust, e këtë po e quan ndihmë. Për disa kontributpagues që po kalojnë nëpër gjendje të rënduar financiare, kjo edhe mund të jetë e mirëpritur. Mirëpo ky propozim ka dy probleme. Problemi i parë ka të bëjë me shkeljen e parimit, kurse problemi i dytë ka të bëjë me mosarritjen e qëllimit të proklamuar. Që nga themelimi në vitin 2002, për Trustin ka

ekzistuar parimi i paprekshmërisë. Pavarësisht se çfarë ndodhë, as qeveria e askush tjetër nuk mund t'i prekë mjetet e Trustit. Ato mjete u takojnë kontributpaguesve dhe mund të tërhiqen vetëm në rastin kur kontributpaguesi arrin moshën e pensionit. Tani me këtë propozim po shkelet ky parim. Dhe me shkeljen e parimit të paprekshmërisë, Trusti më nuk është i paprekshëm sepse po hapet dera që edhe në të ardhmen secila qeveri që i ka 61 vota në Kuvend, t'i fusë duart në paratë e Trustit. Kësaj here kjo po bëhet duke u dhënë qytetarëve nga 10 për qind të kursimeve. Herën tjetër mund të jetë qeveria ajo që i merr 10 për qind apo 20 për qind të mjeteve, me premtimin se pas një kohe do t'i kompensojë ato. Dhe kësajsoj, me këtë lëvizje dhe shkelje të parimit, shkatërrimi i këtij institucioni bëhet çështje kohe. Së dyti, nëse qëllimi me këtë propozim është që të ndihmohen shtresat e prekura të qytetarëve, atëherë kjo nuk është zgjidhja, qytetarët duhet të ndihmohen me masa të tjera, kjo për shkak se shumica e shtresave të varfra që kanë qenë të punësuar, nuk kanë qenë fare të lajmëruar si punëtorë dhe kontributet e tyre në Trust janë zero. Edhe ata që kanë qenë të lajmëruar, shumica kanë aq pak kursime të grumbulluara saqë nuk përbën ndonjë ndryshim substancial nëse i tërheqin 10 për qind apo jo. Me këtë masë, përfutjesit më të mëdhenj do të jenë ata që i kanë pagat e mira dhe të rregullta, sepse vetëm ata kanë mundur që të grumbullojnë kursime në Trust. Prandaj, konsideroj se shkelja e një parimi që nuk është shkelur që 18 vjet, në këmbim të një gjysmëzgjidhjeje, nuk do të duhej të ishte opSION real. Ne do

të jemi të gatshëm të diskutojmë dhe propozojmë zgjidhje më të mira, se si t'u ndihmohet qytetarëve, pa pasur nevojë që të preken kursimet e tyre.

"Epoka e re": Z. Murati, disa nga ndërmarrjet publike janë në gjendje të rëndë financiare. Çfarë strategjie duhet ndjekur që të dilet nga kriza financiare në Telekom dhe në Postën e Kosovës dhe pse Vetëvendosja është kategorisht kundër privatizimit të Telekomit?

Murati: Konsideroj se strategjia e ndjekur nga bordet e përkohshme profesionale ka qenë e duhura. Shkarkimi i personave jokompetentë apo të dëmshëm për interesat e ndërmarrjes, ndërprerja e kontratave të dëmshme, kallëzimet penale për shkeljet e bëra dhe ulja e shpenzimeve si në paga, po ashtu edhe në ato operative, ishin një hap i mirë drejt rrugës së duhur. Por edhe kjo gjë u ndal me shkarkimin e këtyre bordeve nga qeveria jolegjitime, vetëm për t'i mbushur ato me njerëzit e vjetër, të cilët janë arsyeja pse ndërmarrjet publike janë në këtë gjendje të rënduar.

"Epoka e re": Sipas jush, çfarë epilogu do të ketë puna e komisionit hetimor në lidhje me privatizimet?

Murati: Është herët të flitet për epilogun, sepse fushëveprimi i komisionit është i gjerë dhe ka shumë punë, dhe gjatë rrugës mund të kemi të gjetura që s'i kemi ditur. Mirëpo, jam i bindur që raporti do të jetë tejet profesional dhe ne si grup parlamentar do të bëjmë të pamundurën që të zbardhen të gjitha shkeljet, abuzimet dhe manipulimet që janë bërë në procesin e privatizimit në Kosovë.

"Epoka e re": Ju keni iniciuar ndryshimin e Ligjit për Automjete. A besoni se heqja e homologimit do ta marrë mbështetjen e shumicës së deputetëve?

Murati: Nëse deputetët i qëndrojnë besnik betimit të dhënë në Kuvend me rastin e marrjes së mandatit, atëherë mbështetja do të vinte natyrshëm. Sepse po flasim për mbrojtjen e interesave të qytetarëve përballë zhvatjes që u bëhet nga një kompani private, zhvatje kjo e mundësuar nga vetë shteti. Andaj është koha e fundit që shteti ta përmirësojë gabimin e bërë dhe t'ua heqë qafe qytetarëve këtë zhvatje.

"Epoka e re": Z. Murati, si e vlerësoni punën e qeverisë Hoti?

Murati: Ma thoni një vendim të vetëm që është marrë deri tani në interesin e qytetarëve dhe, ndoshta, do të mund të përgjigjesha.

"Epoka e re": Vetëvendosja tashmë ka iniciuar mocionin e mosbesimit ndaj qeverisë Hoti. Pse e keni iniciuar këtë mocion mu në mes të pandemisë, kur nga ana e LV-së kishte akuza për rrëzim të qeverisë Kurti, pikërisht në kohë pandemie?

Murati: Qeveria dhe qeverisja duhen parë si mjete, me anë të të cilave përpiqesh t'ua përmirësosh jetën qytetarëve nga të cilët je votuar. Qeveria nuk duhet parë si qëllim në vetvete. Thirrjen tonë për të mos e votuar mocionin ne e kemi bazuar në këtë të parën, kurse ata që po mundohen të tërheqin paralele tani në mes të mocionit të LDK-së dhe mocionit të Lëvizjes Vetëvendosjeje, bazohen në këtë të dytën, pra që qeveria është vetë qëllimi. Kur ne kemi bërë thirrje të mos rrëzohet qeveria, nuk e kemi bërë këtë nga qejfi dhe dëshira për t'i

mbajtur pozitën si qëllim në vete, por nga nevoja për ta vazhduar menaxhimin e mirë me situatën pandemike, duke e ditur që ndryshimi në një qeveri me legjitimitet të munguar e që nuk ka interesat e qytetarëve prioritet, do t'i hapte rrugë virusit dhe do të na sillte buzë një katastrofe humanitare. Ashtu edhe ndodhi. Tani që kemi arritur këtu si pasojë e keqkqerisjes, është detyrë e jona që ta ndalim të keqen sa më herët që është e mundur, jo për të ardhur në pushtet si qëllim në vete, por që ai pushtet të përdoret për ta rikthyer situatën në kontroll dhe të ndalet degradimi i mëtutjeshëm.

"Epoka e re": A besoni se do ta keni përkrashjen e PDK-së dhe a do të kërkonin nga ta që ta nënshkruajnë këtë mocion?

Murati: Para se të dilnim me mocion, PDK-ja në më shumë se një rast ishte shprehur e gatshme ta nënshkruante mocionin. Tani që dolëm me mocion, ndryshoi qëndrimi i saj. Kjo vetëm e betonon atë që e kemi thënë që nga fillimi, se PDK-ja është opozitë vetëm në letër sepse, në fakt, koordinimi i tyre me LDK-në në shumë raste është më i mirë sesa i LDK-së me partnerët zyrtarë të koalicionit.

"Epoka e re": Sipas jush, kur do të duhej të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare?

Murati: Sa më parë që ndalet degradimi i situatës, aq më të lehtë do ta kemi rimëkëmbjen.

"Epoka e re": Në rast se Vetëvendosja do të dilte partia e parë, potencialisht kush do të jenë partnerët e saj në qeverinë e re?

Murati: Këtë situatë duhet ta vlerësojmë pas zgjedhjeve por, një gjë është e sigurt, vijat e kuqe mbesin aty ku kanë qenë.

Hoti: Hapja e shkollave varet nga situata epidemiologjike

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se në përputhje me vendimin e qeverisë të datës 28 korrik 2020, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) janë duke e përgatitur udhëzuesin për mënyrën e organizimit të vitit të ri shkollor, i cili do të fillojë nga 1 shtatori. Ai ka theksuar se vendimi final për hapjen e shkollave do të ndikohet nga gjendja epidemiologjike me Covid-19.



"Në procesin e vendimmarrjes do të përfshihen plotësisht komunat, të cilat do të kenë përgjegjësi që t'i zbatojnë udhëzimet. Gjatë javës që vjen do të jemi në kontakt me kryetarët e komunave dhe drejtorët për arsim për t'i diskutuar modalitetet e mundshme të fillimit të vitit shkollor. Jemi duke shqyrtuar edhe platformat e ndryshme të ndihmesës për stafin mësimdhënës dhe nxënësit, sidomos në organizimin më të mirë të punës praktike në

arsimin e mesëm profesional", ka shkruar Hoti në llogarinë e vet në "Facebook".

Për këtë çështje, nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosjeje, Arbërie Nagavci, ka bërë me dije se sot (e hënë) në Kuvend do të iniciojnë diskutim parlamentar, duke theksuar se prindërit dhe personeli i arsimit duhet të dinë se ç'është në lidhje me fillimin e vitit të ri shkollor. Ajo ka thënë se MASH-i duhet të marrë vendime për secilin nivel të shkollimit.

Kosova prin me vdekje në rajon, pacientët po lajmërohen “me vonesë” në spitale

Prishtinë, 9 gusht - Java e fundit e muajit korrik shënoi fillimin e rritjes së numrit të vdekjeve në Kosovë të pacientëve të infektuar me koronavirus. Më 30 korrik në Kosovë vdiqën 16 persona brenda një dite, që ishte numri më i madh i vdekjeve që nga paraqitja e rasteve të para. Numër të njëjtë vdekjesh Kosova regjistroi edhe më 6 gusht. Që nga muaji mars, kur u shfaqën rastet e para me koronavirus, e deri më 8 gusht në Kosovë kanë vdekur 315 pacientë të prekur me Covid-19, sëmundjen që e shkakton koronavirusi.

Salih Ahmeti, infektolog në Klinikën Infektive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ka thënë për

“Radion Evropa e Lirë” se numri i vdekjeve është rritur për shkak se është rritur edhe numri i të shtrirëve. Ahmeti ka thënë se pacientët po shtrihen me vonesë në spital dhe kjo po e vështirëson edhe punën e stafit mjekësor.

Ndërsa Nehat Baftiu, drejtor i Klinikës së Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv në QKUK, ka thënë se që 20 vjet ka mungesë të anesteziologëve në Kosovë.

Nga data 29 korrik e deri më 8 gusht në Kosovë kanë vdekur 138 pacientë me Covid-19. Ky numër i viktimave është shumë më i madh se në vendet e tjera të rajonit. Nga 29 korriku deri më 8 gusht në Shqipëri kanë vdekur 44 pacientë. Numër pak më i madh i viktimave



është shënuar në Bosnje e Hercegovinë. Nga 29 korriku deri më 8 gusht atje kanë vdekur 88 pacientë, ndërkaq në Serbi kanë vdekur 81

pacientë, kurse në Mali të Zi është shënuar numër i vogël i viktimave. Në këtë vend fqinj kanë vdekur 14 pacientë që ishin të

infektuar me koronavirus. Në Maqedoni të Veriut nga data 29 korrik e deri më 8 gusht kanë vdekur 47 pacientë nga koronavirusi.

12 të vdekur, 142 të shëruar dhe 188 raste të reja me Covid në Kosovë



PRISHTINË, 9 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë shëruar 142 persona dhe janë paraqitur 188 raste të reja me Covid-19. Sipas IKShPK-së, në 24 orët e fundit si pasojë e Covid-19 kanë vdekur edhe 12 persona. “Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK me metodën RT-PCR, janë testuar gjithsej 462 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 188 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 10.247 raste nga 40 646 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 327 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 142 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 5 944

raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 976”, ka njoftuar IKShPK-ja.


Më tutje, IKShPK-ja ka njoftuar se rastet e reja janë nga Prishtina, Ferizaj, Peja, Podujeva, Mitrovica, etj. “Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 28 raste, komuna Ferizaj 21 raste, komuna Pejë 21 raste, komuna Podujevë 20 raste, komuna Mitrovicë 19 raste, komuna Gjilan 11 raste, komuna Fushë Kosovë 9 raste, komuna Gjakovë 9 raste, komuna Prizren 9 raste, komuna Vushtrri 8 raste, komuna Skenderaj 5 raste, komuna Deçan 4 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Lipjan 4 raste, komuna Viti 4 raste, komuna Klinë 3 raste, komuna Zubin Potok 3 raste, komuna Kamenicë 2 raste, komuna Rahovec 2 raste dhe me nga një rast komunat Obiliq dhe Shtime”, ka njoftuar IKShPK-ja.

Jakup Krasniqi shërohet nga Covid-19

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Këshillit Kombëtar i Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, është shëruar nga koronavirusi. Në profilin e vet në “Facebook”, ai ka shkruar se të premtën ka bërë testin për Covid-19, ku ka dalë negativ. Krasniqi ka treguar se gjatë përballjes me virusin nuk ka pasur ndonjë problem serioz. “Faleminderit të gjithëve! Të

nderuar, shokë, miq e dashamirë, të premtën kam bërë testin për C-19. Kam dalë negativ. Do të thotë, jam shëruar plotësisht, ndonëse nuk kam pasur ndonjë problem serioz. Në rend të parë falënderoj të gjithë mjekët, shokët e miqtë që më ndihmuan me këshillat e tyre profesionale, si dhe të gjithë ata shokë e miq që u shqetësuan dhe u interesuan

për shëndetin tim dhe më uruan shërim të shpejtë. I falënderoj edhe ata që për shkaqe të ndryshme në këtë kohë pandemie nuk mund t'i shprehin urimet e mendimet e tyre. Konsideratat më të larta profesionale e njerëzore, për punën e palodhshme që po e bëjnë ditë e natë për shëndetin e publikut. Respekt për të gjithë!”, ka shkruar Krasniqi.



Një patrullim i sinkronizuar i KFOR-it me xhandarmërinë serbe në fshatin kufitar Karaçevë ka nxitur reagime të shumta

Opozita kritikon qeverinë për futjen e xhandarmërisë serbe në Kosovë



Lëvizja Vetëvendosje dhe Partia Demokratike e Kosovës kanë fajësuar qeverinë për futjen e xhandarmërisë serbe për patrullim në Karaçevë të Kamenicës. Partitë opozitare kanë vlerësuar se ky veprim i toleruar nga qeveria dhe KFOR-i është cenim i rëndë i sovranitetit të Kosovës. Ndonëse qeveria ka vlerësuar se ky ishte një patrullim i përbashkët rutinor dhe i sinkronizuar i KFOR-it me ushtrinë serbe, ministrja e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë se patrullimi nuk ishte i tillë

Duhet hetim e raport i hollësishëm thotë kryeministri i hutuar përderisa nuk ka kurrfarë ndjeshmërie për cenimin e sovranitetit dhe jetën e sigurinë e banorëve të republikës në atë pjesë”, është thënë në reagimin e LV-së.

Edhe PDK-ja ka vlerësuar se provokimet e vazhdueshme të forcave serbe në fshatrat e kufirit në sytë e KFOR-it janë të papranueshme. “Partia Demokratike e Kosovës dënon ashpër praninë e ushtrisë serbe në territorin e Kosovës. Ky veprim i toleruar nga Qeveria e Kosovës dhe KFOR-i është cenim i rëndë i sovranitetit dhe sigurisë kombëtare. Është kërcënim i hapur ndaj tërësisë territoriale dhe sigurisë së qytetarëve të Kosovës. Provokimet e vazhdueshme të forcave ushtarake serbe në fshatrat e brezit kufitar dhe brenda territorit të Kosovës në sytë KFOR-it që e ka atë përgjegjësi, janë të papranueshme”, është thënë në reagimin e PDK-së.

Sipas PDK-së, nevoja e relaksimit dhe mirëkuptimit të raporteve mes fqinjëve nuk e arsyeton veprimin e futjes së ushtrisë serbe në territorin e Kosovës. “Në kohën kur udhëheqësit e lirisë, të shtetit dhe Kosova po goditen pikërisht për luftën e drejtë

kundër asaj ushtrie vrastare, nuk është momenti i eksperimenteve të tilla me simbolika që rikthejnë vetëm dhimbjen dhe terrorin për qytetarët e vendit”, ka vlerësuar PDK-ja.

Ndërsa ish-zëvendëskryeministrja e Kosovës, Edita Tahiri, ka theksuar se reagimi i qeverisë ishte i zbehtë ndaj këtij rasti, duke shtuar se nga zyra e qeverisë nuk mbrohen kufijtë. “Përpjekjet sekrete për t'i prekur kufijtë e Kosovës dështuan. Këto ditë Serbia shkeli haptazi kufirin në Karaçevë. Reagimi i institucioneve ishte i zbehtë, mbeti vetëm në fjalë. Nga zyra e qeverisë nuk mbrohen kufijtë”, ka shkruar Tahiri në profilin e vet në “Facebook”. Nuk kanë reaguar vetëm subjektet opozitare për këtë rast. Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës në Qeverinë e Kosovës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka thënë e ngjarja e 7 gushtit në Karaçevë nuk ka qenë patrullim i sinkronizuar, por patrullim i përbashkët në mes të KFOR-it dhe Serbisë. Sipas saj, për këtë gjë askush nuk ka mandat e as autorizim. “Ngjarja e 7 gushtit në Karaçevë nuk rezultoi në jetë patrullim i sinkronizuar, por patrullim i përbashkët me Serbinë, për të cilin nuk ka

askush mandat e as autorizim. Popullit të shqetësuar duhet t'i sqarohet se a e ka shkelur Serbia marrëveshjen me NATO-n që ka hyrë 300 metra brenda territorit të Kosovës, apo këtë e ka bërë me aprovimin paraprak!”, ka shkruar Stublla në profilin e vet në “Facebook”. Sipas saj, mekanizmat e sigurisë në asnjë mënyrë nuk do të duhej të lejojnë, aq më pak të lehtësojnë patrullime të tilla në territorin e Republikës së Kosovës, që shkaktojnë shqetësime dhe pasiguri te qytetarët e asaj ane. “Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës i bën thirrje bashkësisë ndërkombëtare që t'i respektojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, ashtu siç e kanë njohur gati 2/3-tat e shteteve të botës, 22 nga 27 shtete anëtare të BE-së, dhe 26 nga 30 shtete anëtare të NATO-s e, po ashtu, ta respektojë vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që konfirmoi ligjshmërinë e plotë të pavarësisë të Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008 në kufijtë ekzistues”, ka shkruar ajo.

Ndërsa ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka treguar se pas këtij rasti ka takuar komandantin e KFOR-it, gjeneralmajorin Michele Risi, i cili e ka njoftuar se hyrja e forcave të xhandarmërisë serbe në territorin e Kosovës ka qenë vetëm një patrullim i përbashkët i këtyre forcave me pjesëtarët e KFOR-it. “Nga gjenerali Risi u njoftova se KFOR-i ishte alarmuar për këtë incident nga raportimet e mediave, pasi që një veprim i tillë ka qenë vetëm një patrullim i përbashkët rutinor dhe i sinkronizuar i KFOR-it dhe i Forcave të Armatosura të Republikës së Serbisë, me të cilat që nga viti 2008, KFOR-i zhvillon patrullime të përbashkëta përgjatë vijës kufitare. Pra, ky ka qenë vetëm një patrullim i përbashkët”, ka treguar Veliu në profilin e tij në “Facebook”.

Edhe KFOR-i përmes një komunikate për media ka treguar se të premten rreth orës 17:20 ka kryer një patrullë të sinkronizuar me Forcat e Armatosura Serbe në afërsi të fshatit Hodonovc në Komunën e Kamenicës. Sipas tyre, Forcat e Armatosura të Serbisë nuk u ndahen anëtarëve të KFOR-it gjatë patrullimit si dhe rasti i djeshëm ishte njëjtë.

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 9 GUSHT - Subjektet opozitare kanë dënuar praninë e ushtrisë serbe në Karaçevë të Komunës së Kamenicës.

Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e kanë fajësuar Qeverinë e Kosovës, duke thënë se ka lejuar që xhandarmëria serbe ta shkelë territorin e Kosovës. Lëvizja Vetëvendosje reagimin e qeverisë ndaj kësaj ngjarjeje e ka quajtur të ngathët. “Qeveria e Kosovës, institucionet vendore, në vend se të kujdesen për rendin dhe ligjin, e të sigurojnë mbrojtje për qytetarët në këto pjesë, po vazhdojnë të jenë të ngathëta,

neglizhente, ta bartin përgjegjësinë te KFOR-i, e madje edhe të shfaqin mosbesim ndaj banorëve e vetë institucioneve tona”, ka vlerësuar LV-ja duke shtuar se hyrja e ushtrisë serbe në territorin e Kosovës ishte shkelje e sovranitetit. “Si u bë që KFOR-it, e askujt tjetër i takon ajo pjesë sipas marrëveshjes së Kumanovës, e ndërkohë shohim ecje të lirë e të rëndë të xhandarmërisë serbe aty dhe askund ndonjë institucion vendor të sigurisë? Si u bë që Policia e Kosovës nga vendi i ngjarjes konfirmoi se ata janë pjesëtarë të xhandarmërisë, kurse më vonë kur pjesëtarë të Policisë së Kosovës shkuan në Karaçevë nuk panë asgjë?

Pakoja Emergjente, nga sot nis ekzekutimi i mjeteve financiare për punëtorët dhe bizneset

PRISHTINË, 9 GUSHT - Ministria e Financave, Hykmete Bajrami, ka konfirmuar se nga sot (e hënë) do të nisë transferimi i parave për qytetarët dhe bizneset në llogaritë e tyre. Ajo ka thënë se gjatë javës do të ekzekutohen të gjitha pagesat bazuar në Pakon Emergjente. "Ministria e Financave nga e hëna do ta nisë ekzekutimin e pagesave për qytetarët dhe bizneset për muajt e papaguar. Në Ministrinë e


Financave po punohet pa orar. Thesari dhe Departamenti i Buxhetit po bëjnë të gjitha përgatitjet që nga e hëna ta fillojnë ekzekutimin e pagesave nga Pakoja Emergjente për qytetarët dhe bizneset. Javën që po vjen do t'i ekzekutojmë të gjitha mjetet për muajt e papaguar bazuar në Pakon Emergjente", ka shkruar Bajrami në llogarinë e vet në "Facebook". Me këtë rast, Bajrami u ka

kërkuar falje qytetarëve dhe bizneseve për vonesat pasi, sipas saj, ishte e pamundshme të kryeshin pagesat pa u rishikuar buxheti. "Falënderoj stafin e Ministrisë së Financave, i cili po punon pa orar dhe ka punuar gjithë kohën e pandemisë duke vënë edhe shëndetin në rrezik. Disa punëtorë të Ministrisë kanë rezultuar pozitivë me virus dhe ju urojmë shërim të shpejtë!", ka shkruar Bajrami.



Bizneset nëpër komuna, në gjendje të rëndë

PRISHTINË, 9 GUSHT - Pandemia, përveç shëndetin publik, ka goditur edhe ekonominë në vend, ku bëjnë pjesë edhe bizneset nëpër komuna. Subjektet ekonomike më të goditura janë ato të gastronomisë dhe kompanitë me veprimtari prodhuese. Shumë biznese në Komunën e Dragashit janë në gjendje të rëndë dhe ndodhen pranë shuarjes për shkak të ndikimit nga pandemia.



Kryetari i Komunës së Dragashit, Shaban Shabani, ka thënë se gjendja është shumë e rënduar të bizneseve. "Gjendja është shumë e rënduar të bizneseve. Shpresojmë se me pakon emergjente sadopak do të

mbështeten, por prapëseprapë bizneset në Komunën e Dragashit nuk janë shumë të fuqishme sa ta përballojnë këtë situatë. Si komunë edhe më herët kemi marrë vendim që t'i heqim taksat komunale

përkundër që kemi një buxhet të kufizuar. Është bërë falja e qirave për gjashtë muaj për ato biznese që e shfrytëzojnë pronën komunale por, megjithatë, duket se nuk do të jetë e mjaftueshme... Ndryshe,

nëse zgjat kjo situatë kam frikë se një pjesë e tyre edhe do të falimentojnë, kur kihet parasysh fakti se bizneset e Komunës së Dragashit varen shumë edhe nga prania e bashkatdhetarëve që vijnë për pushime, ndërsa këtë vit kanë arritur që të vijnë vetëm një numër i vogël i tyre", ka thënë Shabani. Më tutje, Shabani ka shprehur shqetësim edhe për mungesë të furnizimit të rregullt me energji elektrike. Po ashtu, efektet e një goditje të rëndë të ekonomisë janë evidente edhe në Komunën e Fushë-Kosovës. Zëdhënësi i kësaj komune, Ali Topalli, ka thënë për "Kosovapress" se ekonomia në Fushë-Kosovë është duke

pësuar në vazhdimësi. "Është një gjendje e rëndë, është një prej segmenteve që është goditur jashtëzakonisht shumë dhe po goditet edhe në këto ditë. Ne si komunë e kemi të pamundur që t'u dalim në ndihmë të gjithë atyre bizneseve që janë të goditura nga pandemia, por që po shpresojmë shumë që pas miratimit të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës, sigurisht se ministritë përkatëse do t'i dalin në ndihmë ekonomisë, në këtë rast atyre që janë më të goditura", ka thënë Topalli. Administrata Tatimore e Kosovës ende nuk ka shifra të sakta për numrin e bizneseve që kanë falimentuar në kohë pandemie.

Bie importi i automjeteve për 30 për qind

PRISHTINË, 9 GUSHT - Si pasojë e pandemisë në Kosovë është shënuar rënie e konsiderueshme e importit të automjeteve me rreth 30 për qind. Ndonëse gjatë kësaj periudhe Kosova ka rënie të importit në përgjithësi për produkte të ndryshme që kanë ndikuar edhe në arkëtimin e të hyrave nga Dogana me një rënie prej 12-përqindësh.



Zëdhënësi i Doganës së Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë për "Kosovapress" se gjatë pandemisë rreth 2 500 automjete janë importuar më pak, krahasuar me

periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ai ka thënë se,

sikurse në gjithë botën, edhe në Kosovë për automjetet e

përdorura impakti është më i madh në import. "Kosova nuk ka mundur t'i ikë trendit global të zvogëlimit të tregut të automjeteve. Në gjithë botën ka pasur ulje drastike të veturave të cilat janë shitur. Te ne kjo është reflektuar me një ulje të konsiderueshme. Për automjetet e reja rënia ka qenë nga 2 100 sa janë shitur deri në fund të korrikut, këtë vit kemi rënë në 1 500 automjete ose rënia ka qenë rreth 30 për qind automjete më pak të reja. Ndërsa për automjetet e përdorura impakti është edhe më i

madh. Rreth 2 500 automjete kemi më pak të importuara gjatë kësaj kohe të pandemisë, që do të thotë ka rënie mbi 20 për qind në të dyja këto fusha. Nëse më herët kemi pasur rreth 11 mijë automjete të importuara gjatë shtatë muajve të parë të vitit, tani kemi vetëm 8 500 automjete. Ka një rënie prapë të vazhdueshme të automjeteve", ka thënë Stavileci.

Sa iu përket të hyrave nga Dogana, ai ka thënë është një rënie e konsiderueshme me mbi 70 milionë euro deri tash.

"Frutex"-i rrit eksportin për 20 për qind gjatë pandemisë

PRISHTINË, 9 GUSHT (ER) - Kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia me virusin Covid-19 ka ndikuar në rënien e shitjeve në tregun e Kosovës edhe me produktet e prodhuara në "Frutex", por kjo rënie në tregun vendor është kompensuar nga rritja e eksportit. Në periudhën

janar-korrik të këtij viti, "Frutex"-i ka pasur një rritje prej 20 përqindësh në eksport. Rritja më e madhe ishte në tregun e Gjermanisë, Zvicrës, Belgjikës, Jordanisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë. Sipas përfaqësuesve të kompanisë "Frutex" edhe në muajt në vazhdim presim të

këtë rritje të eksportit. Vlen të theksohet se kompania "Frutex" eksporton produktin "Golden Eagle" dhe "Relax", në afër 30 vende të botës me shtrirje në katër kontinentet e globit. "Frutex"-i vazhdon të punojë me kapacitete të plota në rritjen e eksportit nga dita në ditë.



Rreth 100 milionë euro më pak të hyra në arkën e shtetit

Buxheti i Kosovës brenda gjashtë muajve ka më pak të hyra për afro 100 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Arsyeja e rënies së të hyrave ka ardhur si pasojë e masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së koronavirusit, siç janë kufizimet në ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, shlyerja dhe shtyrja e obligimeve tatimore dhe masa të tjera

PRISHTINË, 9 GUSHT - Si pasojë e pandemisë Covid-19, buxheti i shtetit të Kosovës brenda gjashtë muajve ka më pak të hyra për afro 100 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, thonë zyrtarët nga dy institucionet kryesore për mbledhjen e taksave, tatimeve dhe detyrimeve të ndryshme financiare.

Dy institucionet që kontribuojnë më së shumti në mbushjen e buxhetit të Kosovës janë Administrata Tatimore dhe Dogana e Kosovës. Arsyeja e rënies së të hyrave ka ardhur si pasojë e masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së koronavirusit, siç janë kufizimet në ushtrimin e aktiviteteve ekonomike, shlyerja dhe shtyrja e obligimeve tatimore dhe masa të tjera.

Kosova kishte filluar marrjen e masave për frenimin e përhapjes së Covid-19, sëmundjes që e shkakton koronavirusi, që nga data 13 mars kur ishin raportuar rastet e para me këtë virus në vend. Zëdhënësi i Doganave të Kosovës, Adriatik Stavileci, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se në periudhën janar-

korrik ka pasur rënie të të hyrave në vlerë prej 74 milionë eurosh. "Për periudhën janar-korrik, taksat kanë pësuar ulje për 11.7 për qind më pak se vitin e kaluar. Vitin e kaluar kishim 636 milionë euro, kurse gjatë këtij viti kemi 568 milionë euro. Arsyeja e rënies është rënia e importit të disa produkteve si dhe rëniet në berëzat ndërkombëtare të çmimit të naftës", ka thënë Stavileci.

Sipas buxhetit të Kosovës, i cili kap vlerën mbi 2 miliardë euro, Doganat e Kosovës për arkën e shtetit për vitin 2020 duhet të grumbullojnë mbi 1.2 miliard euro, ndërsa nga Administrata Tatimore e Kosovës rreth 600 milionë euro. Grumbullimi i të hyrave pas gjendjes së krijuar nga pandemia e koronavirusit konsiderohet të jetë vështirësuar edhe në Administratën Tatimore të Kosovës. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, të premten, më 7 gusht, gjatë prezantimit të të dhënave të këtij institucioni, ka bërë me dije se në vitin 2020 janë mbi 23 milionë euro më pak të hyra të mbledhura



nga ky institucion. Sipas të dhënave të ATK-së, në gjashtëmujorin e vitit 2019 të hyrat tatimore në Kosovë kanë qenë në vlerë prej 239.5 milionë eurosh, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2020 janë mbledhur 215.9 milionë euro. "Realizimi i të hyrave tatimore deri më 30 qershor 2020 kap vlerën prej 215,9 milionë eurosh. Vlen të theksohet se inkasimi i të hyrave nga fillimi i këtij viti deri më 18 mars 2020, ka qenë në përputhje me planifikimet e parapara, mirëpo pas kësaj date është vërejtur një trend i uljes së të të hyrave, duke pasur parasysh efektet që ka dhënë Covid-19, si dhe vendimet për shtyrje të afatit të pagesës së detyrimeve tatimore dhe kon-

tribute pensionale", ka thënë Murtezaj.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, ministria e Financave, Hykmete Bajrami, i pati thënë "Radios Evropa e Lirë" se sipas parashikimeve do të ketë rënie të madhe të të hyrave të rregullta të buxhetit. Sipas saj, gjatë vitit 2020 do të ketë 232 milionë euro më pak të hyra. Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, të cilit i ishte bërë rishikim për shkak të mobilizimit të mjeteve financiare për t'i mbuluar pasojat që janë shkaktuar nga pandemia, ka mbuluar mungesën e të hyrave tatimore prej 232 milionë eurosh. Përveç humbjeve në vlerë

rreth 100 milionë euro që janë shkaktuar nga mungesa e mbledhjes së të hyrave tatimore dhe doganore, dëmet e sakta të tjera ekonomike ende nuk janë të evidentuara. Por, nga parashikimet e bëra të institucioneve ndërkombëtare dhe ekspertëve, bëhet fjalë për dëme të mëdha. Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë parashikuar tkurrje të ekonomisë së Kosovës në vitin 2020 për mbi 5 për qind, ndërsa sipas kryetarit të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, nëse Kosova do të ketë tkurrje ekonomike deri në 7 për qind, humbjet mund të sillen jo më pak se 500 milionë euro në Bruto Produktin Vendor.

Pandemia godet naftëtarët, përgjysmohen të hyrat për arkën e shtetit nga ky sektor



PRISHTINË, 9 - Pandemia Covid-19, përveç në shëndetin publik, sikur çdo sektor tjetër në ekonomi, ka goditur edhe sektorin e tregut të derivateve. Sektori i naftës si gjenerues i arkës së shtetit numëron edhe një numër të madh të të punësuarve, por për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë dhe ardhjes së një numri të vogël të bashkatdhetarëve në këtë verë, ka rënie në shitjen e naftës në masë të madhe. Kurse të hyrat nga ky sektor për buxhetin e shtetit gati janë përgjysmuar. Ndonëse nëse vazhdon pandemia dhe

bie qarkullimi i shitjes së derivateve, rrezikohen të mbyllën edhe një numër i madh i vendeve të punës në këtë sektor. Çmimet e derivateve kishin rënë në mënyrë drastike në fillim të shfaqjes së virusit Covid-19 për shkak edhe të rënies së çmimeve në bursën ndërkombëtare.

Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve, Fadil Berjani, ka thënë për "Kosovapress" se po vazhdon situata e vështirë në tregun e derivateve, pasi edhe qarkullimi ka rënë dukshëm. Berjani ka theksuar se sektori i naftës mbush arkën e shtetit me mbi 30 për qind, ndërsa

është harruar nga shteti për mbështetje në kohë pandemie. "Kjo situatë është e vështirë, ku qarkullimi është i vogël kur shihet se në këtë kohë pandemie neve na mungon edhe diaspora. Kjo do të thotë që sektori i naftës nuk është në nivelin siç ka qenë. Sa iu përket çmimeve të naftës në pandemi, ka qenë deri 60 centë të ndikuara nga bursa dhe organizata OPEC. Në këtë situatë prapëseprapë çmimet janë reale dhe më të ulëta në rajon. Megjithatë, me ndikimet e pandemisë qarkullimi nuk është sikur në vitin e kaluar", ka thënë Berjani.

Shpërndahen 200 koshere bletësh për 20 fermerë të Skenderajt

SKENDERAJ, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, së bashku me drejtorin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sokol Sallahu, ka takuar fermerët përfitues të projektit të përbashkët në mes të kësaj komune dhe fondacionit "Qatar Charity", në kuadër të të cilit kanë përfituar 20 fermerë me nga 10 koshere me bletë, 10 koshere të zbrazëta për rritje të biznesit të tyre familjar si dhe me nga një centrifugë mekanike për nxjerrjen e mjaltit. Me këtë rast, Jashari, duke i përgëzuar fermerët përfitues, u bëri thirrje atyre që të punojnë për zgjerimin e

biznesit të tyre, për ta zhvilluar kështu ekonominë dhe për ta zvogëluar papunësinë. Ai ka deklaruar se Komuna e Skenderajt për çdo vit është duke rritur buxhetin për bujqësinë dhe përkrahjen për fermerët e komunës sonë në përgjithësi. Më tutje, Jashari për realizimin e këtij projekti ka falënderuar fondacionin "Qatar Charity" dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer në zhvillimin e bujqësisë në Komunën e Skenderajt. Ndërsa drejtori i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Sokol Sallahu, ka inkurajuar fermerët që të punojnë për zgjerimin e biznesit të tyre duke marrë

shembull të fermerët e suksesshëm që me përkrahje të tillë kanë arritur të krijojnë një biznes të qëndrueshëm dhe të krijojnë vende të punës. 20 fermerët përfitues kanë mbajtur trajnim rreth kultivimit të bletëve nga bletari Zymer Bajraktari, biznesin e të cilit e ka vizituar edhe kryetari Jashari dhe me ç'rast e ka përgëzuar atë për punën dhe përkushtimin e tij në zhvillimin e sektorit të bletarisë. Nga ana tjetër, fermerët përfitues kanë falënderuar kryetarin Jashari për përkrahjen e vazhdueshme në jetësimin e ideve dhe zhvillimit të bizneseve të tyre familjare.



Komuna e Ferizajt nis ndërtimin e 10 shtëpive për familjet skamnore



FERIZAJ, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Ferizajt, Agim Aliu, ka bërë me dije se kjo komunë, në bashkëpunim me Shoqatën "Jetimat e Ballkanit", kanë nisur ndërtimin e dhjetë shtëpive për familjet skamnore të kësaj komune. Aliu ka thënë se këto familje kanë dhënë kontribut gjatë luftës së UÇK-së. "Strehë e buzëqeshje për më nevojtarët. Nuk ka ndjesi më të ngrohtë zemre sesa kur kthen buzëqeshjen e më nevojtarëve. Bashkë me fondacionin e humanistit

Halil Kastrati, Komuna e Ferizajt nisi ndërtimin e 10 shtëpive për familjet në nevojë, familje që dhanë kontributin për mbrojtjen e atdheut në luftën çlirimtare, familje ku dhembshëm rriten jetimë, familje që dora e shtetit nuk i preku deri më tani asnjëherë për t'i ndihmuar. Që nga Gremja, Rakaj, Slivova e Ferizaj, së shpejti ngrënë shtatin bashkë me strehën e re edhe buzëqeshja e gëzimi i munguar në këto familje", ka shkruar Aliu në llogarinë e vet në "Facebook".

Elezaj dhe Toscano pajtohen për fillimin e investimeve në Videjë të Klinës

KLINË, 9 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë, ka pritur në takim kapitenin Giovanni Toscano, shef i CIMIC nga komanda e KFOR-it në regjionin e Perëndimit, me të cilin kanë biseduar lidhur me situatën ekonomiko-sociale

dhe atë të sigurisë në Komunën e Klinës. Kryetari Elezaj ka falënderuar kapitenin Toscano për vizitën dhe për kontributin që ka dhënë KFOR-i në Kosovë dhe në Klinë, si në aspektin e sigurisë, po ashtu edhe në sfera të tjera, duke mbështetur projekte të rëndësishme për

përmirësimin e jetesës së qytetarëve. Gjatë takimit, kryetari Elezaj dhe kapiteni Toscano janë pajtuar që Komuna e Klinës dhe KFOR-i ta bashkëfinancojnë projektin për vendosjen e pompave në fshatin Videjë, që do ta zgjidhë problemin e furnizimit me ujë për banorët e këtij lokaliteti.



Dhurohen barëra dhe materiale të tjera mjekësore për QKMF-në e Shtimes



SHTIME, 9 GUSHT (ER) - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) "Dr. Vezir Bajrami" në Shtime ka pranuar donacion barëra dhe materiale të tjera mjekësore nga organizata bamirëse amerikane "LDS Charities", në kuadër të projektit për vizitat shtëpiake dhe personat me nevojë dhe pa përkujdesje të cilat i

realizon QKMF-ja që një kohë të gjatë. Në praninë e nënkryetarit të Komunës së Shtimes, Rahman Jakupi, drejtorit të Drejtorisë për Shëndetësi, Musa Baftiu, stafit të QKMF-së, përkatësisht drejtoreshës Mirditë Qeriqi, është bërë pranim-dorëzimi i këtyre mallrave. "LDS Charities" ndihmon

kryesisht me projekte në fushën e shëndetësisë dhe në fushën sociale. Kjo organizatë i ka ndihmuar me projekte edhe institucionet e tjera në Shtime, ndërsa së fundmi pritet të realizohet projekti në Qendrën për Punë Sociale, i cili ka të bëjë me dhoma për fëmijët. Shuma e këtij projekti arrin vlerën prej 7 662 eurove.

ASNJË DITË PUSHTETI I PARTISË DEMOKRATIKE TË SHQIPËRISË DHE SALI BERISHA NUK E KA PËRKRAHUR UÇK-në (27)



Shkruan: Kudusi LAMA

Nëse ka njeri që i beson këto që lexohen më lart, le t'i besojë. Por që të bien shpifjet deri në nivele të tilla, saqë ata që kanë mbi 200 banka ku pastrojnë paratë dhe që kanë fuqinë të grumbullojnë mbi një miliard dollarë në vit, të arrijnë deri në vjedhjen e xhepave të qytetarëve, këtë mund ta besojë vetëm ai që do, siç është zotëri Marty ose dikush që thjesht ka dëshirë ta shtojë grumbullin e shpifjeve dhe të akuzave për shqiptarët.

"Në punët e kontrabandës së njerëzve, shqiptarët kontrollojnë plotësisht transferin (transportin tranzit) nëpërmjet Ballkanit drejt Greqisë, duke shfrytëzuar rrugëkalimet me të cilat bëjnë kontrabandën e drogës në vendin e përmendur. Mafia shqiptare ka vendosur lidhje të ngushta me kriminelët turq, afrikanë dhe italianë për punët me emigrantët ilegalë, të cilët i shfrytëzojnë përkohësisht si korrierë për mbartjen e drogës. Përveç shtetasve të Shqipërisë dhe shqiptarëve të Kosovë - Metohisë, bëhet kontrabandë edhe nga migrantët nga Turqia, Pakistani, Sri Lanka, Kina dhe vende të tjera".¹

Çudi, edhe deri në Pakistan e në Kinë kanë arritur shqiptarët të trafikojnë drogë e njerëz për t'u hequr organet apo për ushqim, nuk dihet pse, paskan arritur të shfrytëzojnë edhe "kriminelët turq, afrikanë dhe italianë për punët me emigrantët ilegalë, e njëkohësisht si korrierë për mbartjen e drogës", dhe nuk paskan arritur të shfrytëzojnë asnjë serb për këtë çështje se vetëm serbët dhe Dick Marty janë njerëz të pastër, qytetar, të ndershëm, humanë (s'ka gjë se vrasin me dhjetëra mijëra qytetarë, fëmijë, gra e pleq, pa bërë asnjë faj), vizionar dhe modern, por që po u prishin shumë imazhin shqiptarët të cilët sipas tyre janë të gjithë pa përrjashtim të kriminalizuar, ndoshta për të pastruar shoqërinë nga kriminaliteti e nga kriminalizimi Serbia ka tentuar t'i zhdukë të gjithë.

"Shqipëria është qendra më e madhe në pastrimin e parave dhe tregtinë e drogës në Ballkan. Paratë e fituara me tregtinë e drogës janë kanalizuar

nëpërmjet skemës piramidale të kursimit, falimentimi i të cilës, në vitin 1997, çoi deri në shqetësime drastike politike në këtë vend, në këtë kohë, i dha mundësi narkomafias shqiptare që të zhvillonte punën e saj deri në përmasa të pabesueshme".²

A i lexon shteti shqiptar këto shpifje të ndyra të Serbisë? A ka aq kohë sa të bëjë një padi për shpifje të tilla që vërtetë ia ndyjnë imazhin në botë? Dy rrugë ka, kur të akuzojnë: ose duhet të qëndrosh fortë e të pastros veten publikisht dhe përballë akuzuesit, ose e dyta, duhet të pranosh publikisht se je kriminalizuar dhe nuk të mbetet tjetër veçse të kërkosh të ndëshkohesh botërisht për atë që ke bërë. Cilën duhet e do të bëjë Shqipëria? Nuk besoj se ka pasur e ka kohë të merret me shpifjet e serbëve, sepse po lodhet shumë duke shpifur për vetveten. Turp.

"Lidhja e terrorizmit dhe e krimit të organizuar në Kosovë - Metohi u vendos nën ndikimin e fuqishëm të faktorëve të caktuar politik në Republikën e Shqipërisë, të dyshuar në korrupsion dhe lidhjen me strukturat kriminale. Është e rëndësishme e dhëna se ekspansioni i UÇK-së ndodhi në periudhën e pushtetit të Sali Berishës, të cilit iu atribua "toleranca" ndaj kontrabandës së narkotikëve, aq me tepër që udhëheqësi i Partisë Demokratike, edhe tani, mban lidhje të forta me Hashim Thaqin".³

Asnjë ditë pushteti i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe Sali Berisha nuk e ka përkrahur UÇK-në, pasi ishin të orientuar në zgjidhjen paqësore të çështjes së Kosovës. Duhet thënë se pikërisht për këtë është pranuar tashmë që edhe vetë Hashim Thaqi do të ishte i arrestuar në Shqipëri në vitin 1996, pikërisht si një luftëtarë dhe udhëheqës në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kështu që çdo tentativë shpifëse për të lidhur Hashim Thaqin dhe Sali Berishën si bashkëpunëtorë në krimin e narkotrafikës dhe të terrorizmit në atë periudhë, duke ardhur në ditët e mëvonshme për lidhjet që ata kanë pasur dhe duhet të kishin si udhëheqës të dy shteteve shqiptare është shpifje e ultë.

"Grupet që merren me krimin e organizuar në Republikën e Shqipërisë, në një masë të rëndësishme ndikojnë në vendimet e qeverisë dhe të partive politike. Në qytetin e Shkodrës dhe në rrethinat në një organizatë jashtë ushtrie të

tregtarëve shqiptarë me drogë dhe me armë disponojnë pajisje më moderne se sa ushtria shqiptare. Mafia shpesh ndihmon individët të fitojnë pozita në pushtet, por kur vijnë në pozitë të fuqishme i shfrytëzojnë ata, që të mund të kontrollojnë punën e organeve shtetërore, para së gjithash të policisë, dhe të realizojnë privilegjet".⁴

Unë nuk marr përgjegjësi të pastroj shtetin shqiptar, por që Serbia të dijë se në Shqipëri ka organizata kriminale që janë më të fuqishme se ushtria shqiptare, më duket një shpifje e trashë. Megjithatë unë e di se serbët këtë do të bëjnë dhe do të lëshojnë edhe të tilla të trasha, thua se këto lloj organizatash i furnizon pikërisht Serbia, por edhe sikur t'i furnizojë do t'u ishte dukur tymi diku. Prandaj edhe këto nuk duhet të merren seriozisht nga askush. Por ja që është dikush që i merr seriozisht dhe ia reklamon Këshillit të Evropës si të vërteta, të studiuar e të stërtstudiuar, që duhet të bëhen shkak për të nxjerrë përfundime se vetëm nëpërmjet një gjykimi ndërkombëtar mund të sqarohen.

"Emigracioni shqiptar në Zvicër, Gjermani, Belgjikë, Holandë si dhe në SHBA, ka vepruar nëpërmjet shumë organizatave ilegale ekstremiste, të cilat i kanë rekrutuar shqiptarët dhe i kanë dërguar në Kosovë - Metohi për të hyrë në UÇK, ndërsa disa janë organizuar në territorin e vendeve të lartpërmendura dhe në Shqipëri, në qendra për stërvitjen ushtarake dhe terroristike tashmë të personave të rekrutuar".⁵

Po të ishin rekrutuar njerëz me pahir për të shkuar në përbërje të UÇK-së e për të luftuar në Kosovë, ato shtete që përmenden si, Zvicra, Gjermania, Belgjika, Holanda apo edhe ShBA-të, do të kishin mbajtur qëndrime shumë të ashpra, nuk besoj se Serbia mendon se edhe atje nuk funksionon shteti, siç mendon dhe deklaroi për Shqipërinë dhe Kosovën, për të cilat jemi mësuar se i kemi dëgjuar me mijëra herë duke filluar nga Ilia Graçanini, Nikolla Pashiçi e deri në ditët tona. Por unë di se atje në ato shtete të respektuara, shteti është shumë funksional dhe nuk besoj se kanë nevojë të marrin mend në Serbi, pasi edhe nuk do t'u vlenin se Serbia njeh vetëm veten e ato janë shtete që përveç vetes njohin, vlerësojnë e respektojnë edhe të tjerët. Por unë për këtë periudhë kur në

Kosovë vinin luftëtarë në radhët e UÇK-së nga këto shtete e edhe nga shtete të tjera, do t'u rekomandoja serbëve t'u kthehen medieve të kohës, gazetave, radiove dhe televizioneve, për të parë se si janë përcjellë ata luftëtarë për në vijat e frontit jo vetëm nga shqiptarët por edhe nga qytetarë të tjerë të shteteve prej nga janë nisur. Duhet serbët dhe zotëri Marty t'i shikojnë ato kohë nëpërmjet medieve për të parë se si "janë detyruar" djemtë dhe vashat për të ardhur në radhët e UÇK-së në frontet e luftës.

Kujtoi në këtë moment një vajzë që erdhi në UÇK nga Gjermania dhe që ishte e martuar me një gjerman. Kur më tregoi se nga vinte dhe se ishte e martuar me një gjerman e pyeta: - A të lejoj bashkëshorti të vish në luftë, apo nuk e ke pyetur fare? - E kam pyetur - mu përgjigj - i thash se dua të shkoj në luftë, pasi vendi im po lufton të çlirohet nga pushtimi. Ai mu përgjigj: - po të ishte në luftë Gjermania unë do të kisha shkuar me kohë. Kështu më erdhi leja nga bashkëshorti që të vij në luftë.

Më ka mbetur në mendje prej asaj kohe ky episod dhe po e tregoj në këtë reagim, pasi është një tregues i veçantë i qytetarisë gjermane dhe i shprehjes së dashurisë ndaj atdheut. E të gjithë ata djem e vasha që kanë ardhur në luftë në radhët e UÇK-së nga vendet e Evropës e nga Amerika kanë secili një histori të tillë qytetarie e dashurie për të treguar dhe askush nuk ka histori për të treguar për krime e trafikë, për detyrime e kërcënime, për shtije e blerje, sepse nuk ka pasur dukuri të tilla në ato kohë të krenarisë kombëtare shqiptare.

Veprimtaria e emigracionit shqiptar shikohet në grumbullimin e mjeteve të rëndësishme financiare, të domosdoshme për furnizimin e grupeve terroriste me armatim e pajisje. Paratë e mbledhura në mënyrë të organizuar, me dhënien e kontributeve të drejtpërdrejta për këto qëllime të caktuara, ose pagat, për gjoja për nevoja humanitare të popullsisë shqiptare. Mjetet e paguara nëpërmjet disa bankave ose me kanale ilegale hidhen në Shqipëri dhe në Kosovë - Metohi, por në disa raste paratë i mbartin korrierët që legjendohen me vizitën për familjen".⁶

Nuk e kundërshtoj mënyrën e mbledhjes së mjeteve financiare në diasporë, se shqiptarët bashkatdhetarëve të tyre do t'u drejtoheshin për ndihmë, por vetëm duhet mbajtur në

vëmendje se ato para nuk ishin për të financuar terrorizmin, sepse shqiptarët kurrë nuk kanë kryer vepra terroriste. Terrorizëm ka kryer Serbia që ka masakruar një popull të tërë deri në tentativë zhdukjeje. Por atij që nuk turpërohet prej krimeve të tij, nuk skuqet as kur shpif, qoftë edhe për viktimën e tij. E të tillë janë Serbia e serbët, por i tillë është edhe zotëri Marty që flet në emër të Evropës, për të treguar se si viktima e terrorizmit mund e duhet të jetë terrorist, realisht ashtu duhet trajtuar, se që të trajtoheshin shqiptarët si të kulturoar e modern duhet të mos lëviznin që t'i prisnin në qafë serbët nga i pari tek i fundit. Të lumtë zotëri Mart - Evropiani. "Ne vendet e lartpërmendura, pjesëtarët e emigracionit shqiptar i janë ekspozuar torturës së anëtarëve të mafies shqiptare me të cilët janë detyruar me forcë të bashkëpunojnë dhe, në këtë mënyrë, ndihmojnë terrorizmin në Kosovë - Metohi dhe në Maqedoni".⁷

Ku janë ata shqiptarë që janë ankuar tek serbët se janë keqtrajtuar nga bashkëkombësit që të bëhen pjesë e mafies shqiptare, që për çudi paska pushtuar gjithë botën e nuk paska mundur të depërtojë në Serbi? Turp të kenë ata struktura të mafies shqiptare që shkojnë e bëjnë si të duan në shtete të dobëta si ShBA-të, Kanadaja, Gjermania, Franca, Italia, Kina, etj., e nuk guxojnë të prekin të paprekshmen, të fuqishmen, liderin e të gjitha shteteve të botës, më të fortën Serbinë. Po pati forcë mafia shqiptare mos të merret me shtete të lodhura si ata që përmendëm më lartë por të kthejnë shikimin nga Serbia po patën guxim.

"Fuqia e mafies shqiptare është bazuar në bindjen e fiseve, përkatësisht të vëllazërive. Grumbullimi i fiseve, shpesh deri 20 përbënë brezin mafioz, komandanti (prijësi) i të cilit është njëherazi edhe udhëheqës politik".⁸

¹ Obiliç, Millosh, "Engjëjt e zinj të skëterrës kosovare", "dosjet sekrete", Beograd, 2004, faqe 43, botimi serbisht

² Po aty faqe 45

³ Po aty faqe 45

⁴ Po aty faqe 45

⁵ Po aty faqe 47

⁶ Po aty faqe 47

⁷ Po aty faqe 47

⁸ Po aty faqe 47

Kufiri i Kosovës me Serbinë ndan Perëndimin me Lindjen



Shkruan: Prof. Ass. Dr. Sabri KİÇMARI

Incidenti i hyrjes së trupave serbe në fshatin Karaqevë të Kamenicës shtron nevojën për një analizë më të thelluar të pozitës gjeostrategjike të kufirit të Kosovës me Serbinë.

Pozita gjeografike e Republikës së Kosovës është mjaft komplekse. E gjendur në zemër të Evropës Juglindore (që padrejtësisht quhet Ballkan), Republika e Kosovës kufizohet nga tri vende anëtare të NATO-s: nga Shqipëria në jug dhe jugperëndim, nga Mali i Zi në perëndim, si dhe nga Maqedonia në juglindje. Me të tri këto vende fqinje Republika e Kosovës ka marrëdhënie shumë të mira dhe ndan një numër vlerash të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe orientimit euro-atlantik. Por, në pjesën më të madhe të kufijve të saj, në veri dhe lindje, Republika e Kosovës kufizohet me Republikën e Serbisë, me të cilën nuk i ndan të njëjtat vlera në fushën e sigurisë dhe nuk ka orientim identik euro-atlantik.

Në fakt, kufiri verior dhe lindor i Kosovës sot i ndan dy trendë gjeostrategjikë në fushën e sigurisë: Lindjen me Perëndimin. Në rrafshin gjeostrategjik, Kosova është në një situatë identike me Gjermaninë dhe Austrinë në kohën e Luftës së Ftohtë. Serbia ka një orientim lindor në fushën e sigurisë. Ajo bashkëpunon ngushtë në fushën ushtarake dhe të industrisë së armatimit me Rusinë dhe Bjellorusinë.

Gjatë vizitës së tij në Beograd, në janar të vitit 2019, presidenti rus, Vladimir Putin, deklaroi se "Serbia është partneri strategjik i Rusisë në Ballkan." Serbia ka blerë dy helikopterë ushtarak rusë Mi17 për 25 milionë euro, kurse në dhjetor 2016, Qeveria serbe pati nënshkruar një marrëveshje për ndihmë ushtarako-teknike me Rusinë, si rezultat i së cilës përfitoi gjashtë avionë luftarak Mikoyan MiG-29, 30 tanke moderne T-72 dhe 30 automjete të blinduara BRDM-2. Rusia e ka furnizuar Serbinë me armë radio-elektronike Pishchal dhe komplekse radio-elektronike fikse Taran. Gjatë ushtrimeve luftarake Rusi-Belorusi-Serbi

është furnizuar me makinerinë luftarake Chaborz M-3. Presidenti serb Vuçiq, duke u fotografuar pranë aeroplanëve luftarak pati deklaruar plot emocion se "kam qarë kur pashë dhe dëgjova zhurmën e tyre."

Qeveria e Serbisë ka zgjedhur edhe një adresë tjetër joperëndimore për bashkëpunim në fushën e sigurisë: Republikën Popullore të Kinës. Është njoftuar se Serbia ka blerë nga Kina dronë të armatosur zbulues CH-92A dhe raketa ajër –tokë 18 FT-8C. Është hera e parë që Kina eksporton pajisje të tilla ushtarake në një vend evropian. Serbia është i vetmi vend në rajon që ka refuzuar të aplikojë sanksione kundër Rusisë pas cenimit të integritetit territorial të Ukrainës dhe pushtimit të Krimesë në vitin 2015. Ajo organizon ushtrime ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë me një emërtim agresiv pansllavist "Vëllazëria Sllave." Edhe në fushën ekonomike ndërthurja është e madhe: Kompania më e madhe serbe e naftës, Nafta Industrija Serbie, është blerë nga Gazpromi rus, i cili eksporton gazin e vet në Serbi. Në rrafshin e organizimit të brendshëm shtetëror Serbia nuk ka arritur të etablojë sistemin demokratik sipas modelit perëndimor. Modeli serb është shndërruar në një model illiberal, të ngjashëm me sistemin rus të Vladimit Putinit. Partia Progresive Serbe e presidentit serb Vuçiq, në zgjedhjet e 21 qershorit 2020, i fitoi mbi 60% të zgjedhjeve, në kohën kur opozita i bojkotoi zgjedhjet. Partia e dytë në radhë

fitoi vetëm 10% të zgjedhjeve. Një rezultat tipik për një sistem autokratik, ku kontrollohen mediet, manipulohen zgjedhjet dhe frikësohet opozita.

Në fakt, Republika e Serbisë paraqet një paradoks të llojit të vet në Evropë: në njërin anë ka shpallur vullnetin për t'u pranuar në Bashkimin Evropian dhe në anën tjetër është në partneritet të ngushtë ushtarak me Rusinë. Është i vetmi vend, që përgjatë procesit të negociimit për pranimit në BE, organizon ushtrime ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë, blen armatim nga Rusia dhe ka hapur një Qendër Humanitare Ruso-Serbe, që në fakt është një qendër spiunazhi rus në Nish. Para pak kohësh zyrtari i lartë i State Departamentit të ShBA, Hoyt Yee, pati paralajmëruar para Subkomitetit për Çështje të Jashtme të Senatit të ShBA-së se "nëse Serbia e lejon Rusinë të krijojë një qendër të tillë spiunazhi në territorin e saj, ajo do të humb kontrollin në një pjesë të territorit të saj."

Qëndrimi i Serbisë ndaj Kosovës është vetëm një nga shumë dimensionet e orientimit të saj joperëndimor. Bashkëpunimi i ngushtë ushtarak në mes të Serbisë dhe Rusisë e ka vendosur Bashkimin Evropian në një pozitë tejet të palakmueshme: të distancohet për të pranuar në radhët e saj një vend me një lidhje kaq të ngushtë ushtarake me Rusinë, i cili e konsideron veten zonë ruse të influencës. Qeveria serbe po e shijon yshtjen e madhe të institucioneve të BE për ta shkëputur Beogradin nga Moska dhe orientuar atë drejt

Brukselit. Kjo yshtje është paradoksale dhe instrumentale. Një mision i tillë është i pamundur.

Udhëheqësit e institucioneve të BE dhe vendet anëtare të BE duhet ta kuptojnë se orientimi i Serbisë drejt Bashkimit Evropian është një farsë, një lloj aktrimi. Baza e këtij interesimi, të shfaqur publikisht, është interesi ekonomik. Rusia nuk mund t'i ofrojë Serbisë, atë që i ofron BE dhe integrimi në BE, në fushën ekonomike dhe sociale: investimet dhe mbështetjen financiare dhe ekonomike. Por, Serbia ndan me Rusinë një aleancë tradicionale religjioze, politike, ushtarake dhe kulturore, e cila është shumë e fuqishme. Prandaj, vlerat politike demokratike evropiane nuk janë në akord me linjën politike të Republikës së Serbisë. Bashkimi Evropian do të gjendet i kurthuar thellë në paradoksin serb. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina janë duke vuajtur shumë nga ky paradoks. Ai nuk zgjidhet duke e lajmitur Serbinë.

Prandaj, ishte i vetëkuptueshëm miratimi, me të cilin Administrata e ShBA-së dhe e disa vendeve anëtare të NATO-s reagan, kur më 14 dhjetor 2018 Parlamenti i Republikës së Kosovës votoi shndërrimin e FSK-së në ushtri të Kosovës. Ky akt duhet materializuar me veprime tjera konkrete. FSK duhet të përshpejtojë procesin e transformimit dhe marrjen e përgjegjësive që i takojnë. Një gjë e tillë duhet bërë në marrëveshje dhe koordinim të plotë me NATO-n.

Politika e jashtme dhe politika e

mbrojtjes së Republikës së Kosovës duhet ta kenë parasysh faktin se Serbia po investon shumë në armatime. Këto tema duhet biseduar hapur dhe sinqerisht me partnerët tanë evro-atlantikë. Orientimi perëndimor i partive politike dhe shoqërisë së Kosovës, si vlerë e jashtëzakonshme, duhet ruajtur jo vetëm sa për formë, por edhe në përmbajtje. Është e domosdoshme që ky orientim të materializohet jo vetëm në rrafshin politik e ushtarak, taktik e strategjik, por edhe në atë kadrovik. Politikanët e vendit tonë duhet të kujdesen për gjuhën që përdorin në raport me BE-në, NATO-n, ShBA-në dhe Britaninë e Madhe. Ata janë aleatë tanë të natyrshëm dhe të tillë do të mbeten.

Pa marrë para sysh nëse fjala është për një incident provokimi, pasojat e një veprimi të tillë, të depërtimit të trupave serbe brenda territorit të Kosovës, më 7 gusht 20202, në rrafshin psikologjik, për banorët e Karaqevës dhe të gjitha rajonet kufitare të Kosovës me Serbinë janë të mëdha dhe reale. Në rrafshin ndërshtetëror veprimi i tillë është ndërhyrje agresive brenda territorit të një shteti tjetër. Qeveria e Kosovës duhet ta shfaqë pakënaqësinë e saj para vendeve mike dhe partnere. KFOR-i duhet të tregohet i vëmendshëm për të evituar provokime të tilla që ngjallin frikë dhe pasiguri. Policia e Kosovës, FSK-ja dhe AKI-ja duhet të jenë në gjendje të informohen me kohë dhe të marrin masa parandaluese kundër frikësimit të banorëve të rajoneve kufitare.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



E jashtëzakonshme

Shkencëtarët zbulojnë si të rrisin pambuk me ngjyrë



Shkencëtarët australianë kanë thënë se kanë arritur përparime në atë që besojnë se mund të transformojë industrinë globale të tekstileve. Ata kanë thënë se kanë zbuluar se si të rrisin pambuk me ngjyrë në rrugë natyrale. Shkencëtarët në Kanberra, po ashtu janë duke zhvilluar pambuk që është më i fortë dhe më elastik. “Pambuku është natyrisht i bardhë, por të kesh një bimë pambuku që prodhon fibrën e ngjyrosur, kjo është arritje”, ka thënë dr. Colleen MacMillan.

FOTO E DITES



Pamje mahnitëse nga bjeshkët e Deçanit.

BARSOLETA E DITËS



Pacienti: Doktor, nuk jam mirë me shëndet.
Doktori: A po kollitësh?
Pacienti: Jo.
Doktori: A ke ethe dhe çrregullim të nuhatjes?
Pacienti: Jo doktor.
Doktori: Eh pra, e keni koronavirusin dhe jeni asimptomatik.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E rrallë

Zjarri shkatërron tërë fushën, por e lë të paprekur faltoren e adoleshentes së vdekur

Faltorja është ndërtuar më 1997 pasi një vajzë 13-vjeçare kishte vdekur në një aksident trafiku tragjik dhe për habinë e zjarrfikësve, ajo i ka mbijetuar nga zjarri që ka shkatërruar tërë fushën e të korrave. Zjarrfikësit kanë mbetur të tronditur kur gjetën një faltore të ndërtuar për të kujtuar një vajzë adoleshente të paprekur pas një zjarri në fushë. Pamjet e marra nga një prej ekuipazheve të zjarrit tregojnë pasojat e zjarrit në qytetin Armstrong, në provincën veriperëndimore të Argjentinës, Santa Fe, pasi filloi një zjarr në një zonë të kullotave që u përhap në zonat përreth.



DASHI
Çiftet e lëkundura do të duhet që të rregullojnë situatën sa më shpejt që të jetë e mundur. Në punë dëshira për disa ndryshime do të rritet.



DEMI
Çiftet, megjithatë, do të jenë në gjendje të mendojnë për ta hedhur hapin e madh. Puna dhe financat gjithashtu do të përmirësohen.



BINJAKËT
Në frontin e punës do të keni një javë shumë premtuese, edhe nëse ju duket se po ecni ngadalë. Në dashuri duhet të përpiqeni të mos mbylleni aq shumë në vetvete.



GAFORRJA
Thjesht përpiqueni të mos përcillni tensionet e punës në marrëdhënien e çiftit, veçanërisht nëse kjo marrëdhënie tashmë është prekur nga ndonjë debat i fortë.



LUANI
Gushti dhe shtatori do të jenë dy muaj veçanërisht pozitivë për sa i përket dashurisë. Beqarët do të takojnë njerëz të rinj e interesantë.



VIRGJËRËSHA
Çiftet që kanë jetuar larg, do të jenë në gjendje të mbështeten në planetin e dashurisë për t'u afruar më shumë. Puna gjithashtu do të lulëzojë.



PESHORJA
Është koha që të përqendrohemi më shumë në të ardhmen dhe më pak në të kaluarën. Në punë ka ende vështirësi, shumë vonesa ose ngadalësime.



AKREPI
Në frontin e punës ka ardhur koha për t'i korrur përfitimet e punës së vështirë në të kaluarën. Të rinjtë do ta kenë mundësinë të bëjnë zgjedhje të rëndësishme.



SHIGJETARI
Çiftet që kanë përjetuar probleme gjatë muajve të fundit do ta kenë mundësinë të gjejnë harmoninë tani e tutje. Në punë nuk duhet të rrini duarkryq!



BRICJAPI
Në dashuri duhet t'i shmangni polemikat. Pavarësisht nëse dëshironi ta vazhdoni lidhjen ose ta mbyllni përgjithmonë, vendimi do të jetë sërish në dorën tuaj.



UJORI
Disa do të mendojnë të fillojnë një projekt së bashku. Në punë, nëse keni një projekt të lënë mënjanë, ose që po ecën shumë ngadalë, mund të shihni zhvillime të reja të këtij projekti.



PESHQIT
Do të keni mundësi të merrni atë që dëshironi, nëse mund t'i përvishni mëngët dhe të punoni shumë. Në dashuri fillon një fazë mjaft e favorshme.

Këngëtarja shqiptare shërohet nga Covid-19, nis pushimet



Këngëtarja Adelina Thaçi rezultoi pozitive me Covid-19 në fillim të korrikut, por duket se tashmë e ka mposhtur virusin. Me anë të një postimi në rrjetet sociale ajo ka treguar se tashmë ka nisur edhe pushimet me familjen. “Jam e lirë, në

Sarandë, me familjen time”, ka shkruar ajo, duke lënë të nënkuptohet se e ka fituar betejën me virusin. Më 8 korrik këngëtarja zbuloi se ishte infektuar nga koronavirusi dhe kishte simptoma si lodhje, dhimbje të syve, dhimbje koke dhe qafe.

Mozziku falënderon fansat për mbështetjen: Më falni nëse e bëra tollovi pak



Mozziku e ka dëshmuar se ka shumë fansa në disa prej qyteteve të Kosovës. Reperi Mozzik të shtunën e javës që shkoj ka nisur turneun promovues për albumin e ri “Mozzart”. Ai ka vizituar disa qytete të Kosovës me një autobus, ku ka takuar nga afër fansat e tij, duke iu dhuruar atyre nga një “CD” të albumit. Për ta parë Mozzikun, të rinjtë ishin grumbulluar pa distancë, e disa prej tyre edhe

pa maska, pavarësisht rrezikut të infektimit me Covid-19. Reperi nuk ka arritur t’ua plotësojë dëshirën fansave edhe në disa qytete të tjera, përfshirë edhe Prizrenin, pasi policia nuk e kishte lejuar. Megjithatë, Mozzik ka falënderuar edhe një herë fansat për mbështetjen nëpërmjet një videoje të postuar në “Instagram” dhe ka kërkuar falje për gjithë “tollovinë”. “Më falni nëse e bëra tollovi pak”, ka shkruar ai.



Rita Ora vjen me një tjetër pozë provokuese në bikini

Këngëtarja e njohur shqiptare Rita Ora është duke i shijuar në maksimum pushimet në bregdet. Ajo vazhdon të ndajë imazhe për ndjekësit e saj, ku kësaj radhe ka publikuar një foto provokuese teksa

ka pozuar me bikini. Rita ka marrë ngjyrë nga rrezet e diellit dhe kjo e bën të duket akoma më seksi. E veshur me bikini, Rita është dukur tejet joshëse dhe komentet nuk kanë munguar.

Aktorja “ngre” temperaturat



Kurrë nuk ka pasur problem që ta tregojë pamjen. Aktorja dhe këngëtarja e njohur Vanessa Hudgens ka “ngritur” temperaturat me fotot e postuara në rrjetet sociale. Ajo është shfaqur me një palë bikini ngjyrë blu të çelët, ndërkohë që po kalon

pushimet në Ishujt Turks dhe Caicos. Ylli i “The High School Musical” ka treguar fizikun e saj tërheqës për të gjithë fansat. 31-vjeçarja është shfaqur me një varëse argjendi që shpërndahet nëpër të gjithë trupin, ndërsa në gishta mban disa unaza.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Gjilani dhe Prishtina mësojnë kundërshtarët në Ligën e Evropës

Gjilani është treguar me fat në shortin e Ligës së Evropës pasi do të përballet me skuadrën e San Marinos, Tre Penne. Shorti ishte më i vështirë për skuadrën e Prishtinës, e cila do të përballet me kundërshtarin më të vështirë të mundshëm, Lincoln Red



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 9 GUSHT - Dy skuadrat nga Kosova që marrin pjesë në arenën ndërkombëtare, Gjilani dhe Prishtina, i kanë mësuar kundërshtarët e parë në kualifikimet për Ligën e Evropës. Klubi që doli nënkampion në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Gjilani, do të përballet me klubin nga San Marino, Tre Penne. Ndërkohë, fituesja e Kupës së Kosovës në futboll, Prishtina, edhe në këtë edicion do të marrë pjesë në garat parakualifikuese të Ligës së Evropës.

Klubi "bardhekaltër" do të përballet me Lincoln Redin e Gjibraltarit.

Kapiteni i Prishtinës, Armend Thaqi, ka thënë se skuadrës së tij i ka rënë kundërshtari më i vështirë. Ai ka bërë me dije se Prishtina do ta japë

maksimumin për t'u kualifikuar në raundin e parë. "Është hera e tretë që do të udhëtojmë në Gjibraltar. Ndoshta kundërshtari më i vështirë që ka qenë në short. Duhet të përgatitemi maksimalisht që në të gjitha mënyrat ta tentojmë kualifikimin në raundin e parë. Normalisht, pres kalimin tutje, nuk do të jetë e lehtë, sidomos nëse e kujtojmë vitin e kaluar, por duhet të kalojmë tutje. Kemi ende kohë për të punuar në këtë fazë përgatitore dhe duhet të jemi sa më të gatshëm", ka thënë Thaqi. Ndeshjet parakualifikuese luhen me sistemin vetëm një lojë, më 20 gusht.

Drita kualifikohet në finale, nëse e mposhtë Linfieldin përballet me Legjan

Kampionia e Kosovës, Drita, e nisi rrugëtimin në kualifikimet

për Ligën e Kampionëve me fitore, pasi që arriti ta mposhtë klubin nga Andorra, Inter Club d'Escaldes (2-1), kurse golat i shënuan Xhevdet Shabani dhe Hamdi Namani. Drita e fitoi ndeshjen edhe pse në formacionin e saj munguan dy lojtarë me përvojë të madhe si Fidan Gërbeshi dhe Bujar Shabani, pasi i pari rezultoi pozitiv me koronavirus, ndërsa tjetri u detyrua të vetizolohet shkak i kontaktit me Gërbeshin. Dritën e pret finalja e këtij raundi preliminar të Ligës së Kampionëve, ku do të përballet me klubin irlandez Linfield. Kampionia e Kosovës në futboll, nëse e fiton finalen ndaj Linfieldit më 11 gusht në Zvicër, do të përballet me Legjan e Varshavës në raundin e parë eliminator të Ligës së Kampionëve. Kështu është vendosur të dielën në shortin e hedhur në selinë e UEFA-s, Nyon.

SHKURT

Sherifi: Kemi ekip të mirë për kalim tutje në Ligën e Evropës

Skuadra nënkampione e Kosovës në futboll, SC Gjilani, ka mësuar kundërshtarin e parë në Ligën e Evropës, e cila është Tre Penne nga San Marino. Drejtori sportiv i 'Skifterave', Sallah Sherifi, ka thënë për "klankosova.tv" se është optimist për kualifikim në raundin tjetër. "Do të jetë një përvojë e re për ne pasi do të luajmë për herë të parë një ndeshje të tillë dhe ne nga tani si ekip do të marrim informacione për skuadrën kundërshtare. Mendoj se kemi ekip të mirë për kualifikim në raundin tjetër, ku pres nga shtabi teknik ta përgatisë sa më mirë ekipin për këtë takim", ka thënë Sherifi. Tre Penne - Gjilani zhvillohet më 20 gusht në San Marino dhe fituesi i këtij takimi kalon në fazën e parë kualifikuese të Ligës së Evropës.

Blackburni interesohet për Arijanet Muriq

Blackburn Roversi është i interesuar për shërbimet e portierit kosovar Arijanet Muriq. Lajmi është bërë me dije nga gazetari sportiv i 'The Sun', Alan Nixon, me anë të një postimi në "Twitter". 21-vjeçari që është aktualisht lojtar i Manchester Cityt nuk po arrin të gjejë vend në formacionin e Pep Guardiolas. Muriqi së fundi ishte i huazuar te Nottingham Forest në Championship të Anglisë, ku luajti vetëm katër takime.

Bremeni nuk e fton Rashicën

Ylli i Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica, nuk ka qenë i ftuar te Werder Bremeni për miqësoren kundër Eintracht Braunschweig. Lidhur me mungesën e Milotit në skuadër ka folur edhe trajneri i Bremenit, Florian Kohfeldt. "Ne vendosëm që Miloti të mos jetë në skuadër në këtë ndeshje për shkak të situatës për transferimin e mundshëm", ka thënë trajneri. Rashica lidhet me transferimin e mundshëm të skuadra e Milanit, por edhe Leipzigu qëndron mes opsioneve. Mbetet të shihet se ku do të zyrtarizohet lojtari i Kosovës gjatë merkatos së verës.

Arbëria transferon brazilianin Bruno Arrabal

Arbëria e Dobrajës ka konfirmuar zyrtarisht transferimin e brazilianit të njohur, Bruno Arrabal. Arbëria gjatë ditëve të fundit ka nënshkruar me emra të njohur si Arbër Pira, Gëzim Rusi, Agron Bruqi dhe Donat Kaqiu. "KF Arbëria ka arritur marrëveshjen e radhës me brazilianin Bruno Arrabal! Arrabal vjen nga KF Burgan skuadër kjo e cila garon në Kuwait. Arrabal, një lojtar profesional, me përvojë të jashtëzakonshme, përfaqësonte skuadra të shumta si: Remo, Caxias, Tupi, Mirim, Ethnikos, Kamza dhe së fundi skuadrën Burgan. Arrabal do ta bartë fanellën e kuqe të KF Arbëria në rolin e mesfushorit", thuhet në njoftimin e klubit nga Dobraja.

Barça dhe City e dominojnë formacionin në Ligën e Kampionëve

Barcelona dhe Manchester City dominojnë në formacionin e ndeshjeve të dyta të fazës së 1/8-ave të Ligës së Kampionëve. Katalanasit dhe anglezët eliminuan përkatësisht Napolin dhe Real Madridin. Në formacionin e përzgjedhur nga "Whoscored.com" mungon Cristiano Ronaldo, ani pse portugezi i Juventusit shënoi dy gola për "Zonjën e Vjetër" në përballje me Lyonin. Formacioni: Ter Stegen, Semedo, Lenglet, Militao, Sandro, Sterling, Gundogan, De Bruyne, Jesus, Lewandowski, Messi.

Vertappeni dhe Red Bulli befasojnë Mercedesin, dështon Ferrari

SILVERSTONE, 9 GUSHT - Ka përfunduar gara e pestë e Botërorit të vitit 2020 në Formula 1 dhe fituesi është Max Verstappen. Piloti i Red Bull Racing-Honda triumfoi në Çmimin e Madh të Silverstones, që përkoi me 70-vjetorin e kësaj piste. Suksesi i

parë në këtë vit për holandezin, i cili zhvilloi një garë fantastike dhe siguroi pikët e plota. I dyti Lewis Hamilton, teksa në podium ngjitet edhe makina tjetër e Mercedesit, Valeri Bottas. Vendi i katërt për Charles Leclerc te Ferrari, ndërsa Sebastian Vettel

zhvillon një tjetër garë të dobët. Gjermani i "Kokëkuqes" u nis nga pozicioni i 11-të dhe e mbylli në vend të 12-të, duke konfirmuar momentin e errët që po kalon. Hamiltoni vazhdon ta kryesojë renditjen e përgjithshme me 107 pikë.

Kampioni i botës ndiqet nga Verstappen me 30 pikë më pak dhe më pas vjen finlandezi Bottas me 73 pikë. Vetë 45 pikë numëron Leclerc, që pozicionohet i katërti, ndjekur nga Lando Norris me 7 pikë më pak.



Willian: Po largohem nga Chelsea me kokën lart

LONDËR, 9 GUSHT - Merr fund telenovela e Willianit te Chelsea. Braziliiani nuk gjeti gjuhën e përbashkët për të rinovuar me klubin londinez dhe zyrtarisht u largua nga ekipi i Frank Lampardit. Willian ka shkruar një letër të gjatë lamtumire duke i falënderuar të gjithë. "Ishin shtatë vjet të mrekullueshme. Në gusht të 2013-s, kur mora ofertën nga Chelsea, isha i bindur se duhej të luaja me këtë fanellë. Sot jam i sigurt se ishte vendimi i duhur. Ka pasur shumë çaste të bukura, disa jo të mira, ka pasur trofe të fituar dhe gjithmonë intensitet. Pavarësisht prej trofeve, kam mësuar shumë dhe për veten. U rrita, u bëra një lojtar dhe një



person më i mirë. Në çdo stërvitje, në çdo ndeshje dhe në çdo minutë të kaluar në dhomat e zhveshjes kam mësuar gjithmonë", ka shkruar braziliani. "Jam shumë falënderues për tifozët e Chelseas për pritjen e tyre në 'Stamford Bridge' dhe mbështetjen e tyre. Ka pasur dhe kritika, që janë normale, por ajo që është më e rëndësishme është se kishte afeksion nga të dyja anët. Ka ardhur koha që të lëviz. Do të mungojnë shokët e ekipit. I gjithë personeli i Chelseas më ka trajtuar si djalë dhe do të më mungojnë fansat. Largohem me kokë lart, sepse kam fituar trofe dhe kam bërë më të mirën për Chelsean", ka shkruar Willian.

Phoenixi arrin fitoren e gjashtë radhazi

MIAMI, 9 GUSHT - Dallas Mavericku është rikthyer te fitorja, teksa ka arritur të mposhtë Milwaukee Bucksin me shifrat 136-132. Në "The Arena" të Orlandos u zhvillua një nga sfidat më spektakolare të mbrëmjes, ndërsa në fund u desh koha shtesë për ta përcaktuar fituesin. Vendësit arritën ta fitojnë fraksionin e parë dhe të tretë të ndeshjes, ndërsa i dyti dhe i katërti shkoi për Bucksin, duke bërë që koha e rregullt të mbyllej në barazim 119-119. Koha shtesë shkoi në favor të Dallasit që fitoi me shifrat 17-13 dhe gjithë ndeshjen 136-132. Basketbollisti sloven Luca Donçiq ishte protagonist i padiskutueshëm për Dallas Mavericksin, pasi shënoi 36 pikë, rikuperoi 14 topa dhe dha 19 asistime, ndërsa greku Antetokounmpo i Milwaukee e mbylli ndeshjen me vetëm 34 pikë të shënuara. Los Angeles Lakersi nuk është



aspak në formë të mirë që prej rikthimit, pasi ka pësuar edhe humbjen e 5-të në 9 ndeshje. Në "HP Field House" të Orlandos, Indiana Pacers ia doli t'u imponohet miqve nga Los Angeles me shifrat 116-111. T. J. Warren ishte protagonist për Pacers me 39 pikë të shënuara, 5 rikuperime dhe një asistime, ndërsa LeBron Jamesi nuk shkoi më shumë se 31 pikë të shënuara, në një ndeshje të komplikuar për Lakersin. Me fitoren e 6 radhazi dhe të 7-n në

8 ndeshje të zhvilluara që prej rifillimit, Phoenix Suns ka ndezur shpresat për një vend në "play-off". Viktima e radhës e Sunsit ka qenë Miami Heatsi, që në "Visa Athletic Center" të Orlandos luajti vetëm në fraksionin e parë dhe më pas u dorëzua, raporton "SS". Sfida u mbyll me rezultatin final 112-119, ndërsa protagonist absolut në suksesin e Phoenix Sunsit ishte 23-vjeçari Devin Booker, që shënoi 35 pikë, dha 6 asistime dhe rikuperoi 3 topa.

Sportisti kenian rezulton pozitiv me Covid-19

Sportisti kenian Conseslus Kipruto ka rezultuar pozitiv me Covid-19. Është vetë kampioni olimpiq dhe botëror i garave me pengesa 3 mijë metra për meshkuj që e ka bërë të ditur lajmin. Kipruto, fitues i medaljes së artë në

Lojërat Olimpikë Rio 2016 dhe në Kampionatin Botëror 2017 dhe 2019, në një deklaratë nga llogaria e tij në "Instagram" njoftoi se ka rezultuar pozitiv në testin për koronavirus. "Bota po kalon në një periudhë të vështirë

dhe jemi të detyruar që të gjithë t'i përbushim detyrimet tona. Për këtë arsye, nuk do të marr pjesë në garën e Monakos më 14 gusht të Ligës Diamond. Planifikoja të thyeja rekord botëror", ka shkruar ai.

SHKURT

Nuk pensionohet Tevezi

Sulmuesi i njohur argjentinas Carlos Tevez nuk ka ndërmend të tërhiqet dhe ka rinovuar kontratën e tij me skuadrën e Boca Juniorsit edhe për një tjetër sezon. Lajmin e ka dhënë vetë klubi nga Buenos Aires nëpërmjet një postimi në faqen zyrtare, ku njofton zgjatjen e akordit deri në verën e 2021-shit. Ky është sezoni i tretë radhazi për Tevezin me Bocën, fanellën e së cilës sulmuesi 36-vjeçar e ka veshur në tri periudha të ndryshme dhe numëron 204 ndeshje e 73 gola.

Ronaldo në bisedime me PSG-në

Mediat në Francë vazhdojnë t'i qëndrojnë idesë që Cristiano Ronaldo dëshiron të largohet nga Juventusit dhe të transferohet te PSG-ja. Sipas "Footmercato", mësohet se Ronaldo është i frustruar me eliminimin nga Liga e Kampionëve dhe dëshiron ta provojë sërish fitimin e kupës me veshë të mëdhenj me një tjetër ekip. Raportohet se Jorge Mendes, që është agjenti i portugezitet, do të takohet me drejtorin sportiv të PSG-së, Leonardon, gjatë Ligës së Kampionëve në Lisbonë. Situata mund të ketë ndryshuar me shkarkimin e Sarrit dhe emërimin e Andrea Pirlos si trajner të ri te Juventusit. Kontrata e Ronaldos me Juventusin skadon më 2022, por paga e tij prej 30 milionë eurosh në vit po fillon të krijojë shqetësime në klubin bardhezi, pasi financat e Juventusit kanë pësuar rënie, sidomos pas eliminimit në Ligën e Kampionëve.

Del Piero: Pirlo mund të bëhet më i mirë se Zidane

10 ditë pasi ishte emëruar në krye të skuadrës U23 të Juventusit, Pirlo dje është zyrtarizuar si trajner i skuadrës së parë të "Zonja e vjetër". Lidhur me vendimin e Juventusit ka folur edhe ikona e skuadrës, Alessandro Del Piero, i cili ka shprehur besimin e plotë te Pirlo. Del Piero beson se ish-shoku i tij i skuadrës mund të bëjë edhe më mirë sesa ka bërë Zinedine Zidane me Real Madridin. "Të jem i sinqertë, nuk e shihja atë si trajner. Është surprizë për mua", ka thënë Del Piero. "Nuk është krahasim korrekt me Zidane i cili tashmë ka punuar me Real Madridin dhe ishte asistent i Carlo Ancelotti, por Pirlo ka gjithçka për t'u bërë më i mirë sesa Zidane", ka shtuar italianin. Zidane shihet si një nga opsionet për ta marrë drejtimin e Real Madridit. Mbetet të shihet se si tashmë Andrea Pirlo do t'ia dalë në krye të skuadrës së Juventusit, skuadër që përsëri këtë edicion dështoi në Ligën e Kampionëve.

Presidenti i Lyonit: Juve u përpoq të ushtronin presion ndaj gjyqtarit

Lyonit arriti që ta shkaktonte surprizën më të madhe të fazës së 1/8-ve në Ligën e Kampionëve duke eliminuar Juventusin. Pavarësisht se goli i vetëm që shënuan ishte me një penallti shumë të dyshimtë, presidenti i klubit francez, Jean-Michel Aulas, sulmon bardhezinjtë, duke thënë se ushtruan presion ndaj gjyqtarit. "U kënaqa shumë. Kam pasur disa çaste të shkëlqyera në jetën time, por kjo është e veçantë. Juventusit ka një ekip të madh, por në fushë bën shumë presion ndaj gjyqtarit. Gjithsesi gjyqtari u tregua shumë i zoti, duke dalë nga situatat", ka thënë Aulas. "Ekziston një në një milion mundësi, ndaj duhet t'i luajmë shanset tona. Mbyllja e Ligës 1 ishte një skandal i madh, një padrejtësi që nuk do ta falë kurrë. Plaga nga ndërprerja, është akoma e pranishme", ka deklaruar presidenti i Lyonit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Burim Velu" B.I Slivovë, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Slivovë, Prishtinë.


Njoftohet publiku i interesuar se më datën 31.08.2020 në ora 10:30 në hapësirat e restorant "California" në Prishtinë do të organizohet debat publik nga kompania "Burim Velu" B.I Slivovë, Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për stacionin e karburanteve në Slivovë, Prishtinë.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM
<https://us04web.zoom.us/j/2801512624?pwd=aWE5OXNlL3RvU0lPZUdURTRMd1JPQT09>

Meeting ID: 280 151 2624
 Passcode: 059214

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



An EU Funded Project
 Managed by the EU Office in Kosovo



Implemented by Hit Flores ShPK

Contract Title: Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels

Publication Reference: 1-2019/413-249

05 August 2020

Hit Flores Sh.P.K, with the address: Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo, intends to award the contract for: **Supply and Installation of 100 kW of Solar Panels.**

All interested and qualified bidders, national and international, are invited to apply. The tender dossier is available from hit_flores@hotmail.com

The deadline for submission of bids is: **05 September 2020 at 15:00 hours local time** at the following address: Hit Flores Sh.P.K, Sheshi i Deshmoreve, Dragash, 22000, Kosovo.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Krasniqi" Sh.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit: 70917890

► Sherif Ademi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf " Ibrahim Fehmiu " Arbane

► Rushadije Ajazaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Dëshmorët e Zhurit " Zhur

► Aida Alija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Ekrem Rexha " Lubizhd

► "3A ELEKTROSERVISI" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 601541958.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërrlok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139